Likewise, he is denied the request to take a lawyer. The prosecutor informs the fixer that: "As for consulting a lawyer, that is not possible at this stage...In our legal system the indictment comes first. After the preliminary examination the Investigating Magistrate and Prosecuting Attorney consult, and if both believe the suspect to be guilty, an Act of Indictment is drawn up and sent to the District Court, where it is either confirmed or disapproved by the judges. The defense may begin after the accused is informed that the indictment has been voted, and he is given a copy of it. Within a week or so, possibly a bit more, the accused may select his counsel and inform the court." (78) In this way, Bok must, ironically, be declared guilty by the judge and prosecutor, based on the existing evidence, *before* he is permitted to consult a defense lawyer. According to this system, the jury finds out that a individual is declared guilty, prior to being tried. Despite this, Bok waits for more than two years so that his charge is authorized, even though the prosecutor is afraid to take the case to trial, through lack of evidence.

Meanwhile, during his stay in prison, the protagonist is poisoned by the guard, in order to pass the act off as a suicide, out of shame for the ritual murder, what would justify Grubeshov. The latter tries also to scare Bok by telling him that czar himself is notified of his case, considering him guilty. To prove such a thing, the prosecutor shows to the fixer scraps of newspapers related to him: "His majesty expressed himself as justified in his belief that the crime was the dastardly work of a Jewish criminal who must be properly punished for his barbaric deed." (20) The czar needs a Jew, whoever – Bok, the case in point – to keep in check the political tensions.

Czar Nicholas II presents himself as a defender of justice for Russians, and injustice for Jews. Thus, he aims to gain maximum support from Russian masses for his service as a guarantor of their security.

At a lower level, the public prosecutor Grubeshov and other legal officials, such as colonel Bodiansky, give a political flavor to the incident and accusation. In this manner, while initially

accused of murder, the hero comes to be considered as a political prisoner; from a civil offence – according to Bibikov – the case takes on intense political and nationalistic implications, where Bok is suspected of being a member of Jewish political or revolutionary parties, secret organizations that, according to the investigators, pose a major threat to the czar. The latter is nothing but a coward: “I never wanted the crown, it kept me from being my true self, but I was not permitted to refuse... One is born as he is born and that’s all there is to it.” (297) In this way, the czar bears great similarity to Grubeshov, the other fierce violator. It is obvious that a system led by such cowards is doomed to fail because the czar as the head of the Russian state, has no intention of fulfilling human moral and intellectual purposes. “The state”, said Aristotle, “exists to achieve a better life, and not just for the sake of living. . .the political society exists for the sake noble actions, and not simply of society. . .If a state brings a good life or not, this depends on the leaders’ conduct.” (Stumpf, 102) Bok, on the other hand, has reached the conclusion: “I am not the same man I was.” (286) As a result, Bok imagines himself as an attacker against the czar because he believes that he is entitled to act, in order to change history – “there are ways to change it” (299). He acts in line with Sartre’s belief that: “And when we say that a man is responsible for himself, we do not only mean that he responsible for his own individuality, but that he is responsible for all men.” (par.3) While the czar does not agree that the actions of one person can change history, Yakov Bok, an

unimportant repairman manages to make history because he realizes the fact that the individual must be within history, and change it through involvement; even the involvement of a single person counts: “One thing I have learned...there’s no such thing as an unpolitical man, especially a Jew. You can’t be one without the other, that’s clear enough. You can’t sit still and see yourself destroyed.” (299) Then, he heads for the trial, exclaiming: “Death to the anti-Semites! Long live revolution! Long live liberty!” (299)

CONCLUSION

As a conclusion, it can be said that the novel “The Fixer” conveys topical values not only for the time when it came out, but universal ones because it raises the voice against any injustice, prejudice, or violence from the state – which exploits religion and the legal system – against specific masses or ethnic groups, against the individual, in general.

REFERENCES

1. Lasher, Lawrence M., ed. (1991), *Conversations with Bernard Malamud*. New York, Jackson and London: University Press of Mississippi.
2. Malamud, Bernard. (1967), *The Fixer*. New York, Penguin Books.
3. Samuel Enoch Stumpf, (2007), *Philosophy: History and Problems*, (Retranslated from the translation into Albanian by Kastriot Myftiu dhe Paqsor Shehu), Tiranë, Toena.
4. <http://faculty.salisbury.edu/~jdhatley/101EXISTENTIALISM..>

ECONOMIC PROFESSIONAL TERMINOLOGY IN ALBANIAN

TERMINOLOGJIA PROFESIONALE EKONOMIKE NË GJUHËN SHQIPE

SHPRESA HOXHA^a, ARBËRESHA RAÇA – SHALA^b

^a Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës

^b Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS

Email: shpprressaa@hotmail.com; shpresa.hoxha@uni-pr.edu, arberesha.shala@gmail.com

AKTET VII, 3: 222-226, 2014

PËRMBLEDHJE

Gjuha shqipe është degë e gjuhëve indoevropiane, historikisht e njohur, ndërkaq historia e saj e shkruar daton nga shek. XVI. Është e pasur me shumë fjalë dhe shprehje të ndryshme. Por ka nevojë edhe për huazime, sidomos në fushën e ekonomisë, të cilat së fundi vijnë nga gjuha angleze. Mirëpo, nga kjo fushë ka huazuar fjalë edhe nga gjuhë të tjera midis tyre: turke, sllave. Prania e huazimeve turke daton nga koha e Perandorisë Osmane dhe një numër i madh i tyre janë bërë pronë e gjuhës shqipe dhe i gjejmë në fjalorët e saj, si p.sh.: *terzi, usta, berber* etj. Shqipja, duke jetuar në fqinjësi me popujt sllav ka huazuar fjalë edhe nga serbo-kroatishtja. Kohëve të fundit ndjehet një ndikim i dukshëm nga anglishtja, ndihmuar edhe nga globalizimi, i cili ka përfshirë gati tërë Europën dhe shtetet e tjera të botës. Janë disa huazime të më hershme si p.sh.: *kapital* (capital), *sektor* (sektor), *kompani* (company) etc. Huazimet e mëvonshme angleze të përdorura në shqipen janë: *asete, menaxhment, inpute* etj.

Fjalët çelës: terminologji ekonomike; huazimet turke, serbo-kroate dhe angleze.

SUMMARY

Albanian language, a branch of Indo-European languages, is historically known, whereas its written form belongs to the XVIth century and it is rich in different words and expressions and Turkish, Slavonic, and lately with English borrowings in the field of economy. The Turkish borrowings presence dates from the period of the Ottoman Empire and a large number of them are still present in most of Albanian dictionaries like: *terzi, usta, berber* etc. Albanian was also influenced by Serbo-Croatian living in neighborhoods with Slavic people. Lately it is influenced by English also along with the globalization which was embraced almost by all Europe and some other countries all over the world. There are some earlier English borrowings as for example: *kapital* (capital), *sektor* (sector), *kompani* (company), etc. Later used English borrowings in Albanian are: *asete* (assets), *menaxhment* (management), *inpute* (inputs) etc.

Key-words: economic terminology, Turkish, Serbo-Croatian and English borrowings.

HYRJE

Si çdo gjuhë në botë edhe gjuha shqipe ka terminologji profesionale të fushave të ndryshme të studimit, por edhe ndikohet dhe pasurohet me fjalë e shprehje nga gjuhët e tjera më me ndikim në të gjitha fushat, në këtë rast në fushën e

ekonomisë. Edhe pse dihet se gjuha e shkruar shqipe (në mbështetje të dokumenteve të para të shqipes) i takon shekullit XVI, megjithatë ajo është e pasur me fjalë dhe shprehje të ndryshme burimore dhe në vijimësi plotësohet dhe ndikohet edhe nga gjuhë të tjera, varësisht nga afëria territoriale dhe tek ne nga prania e

ndërkombëtarëve në Kosovë në degët e ndryshme të ekonomisë. Në të kaluarën më të largët është ndikuar nga turqishtja, më saktësisht nga periudha e pushtimit të Perandorisë Osmane, e cila ka ushtruar një ndikim të dukshëm dhe pothuajse të pashlyeshëm jo vetëm në shqipen, por edhe në gjuhët e tjera të Ballkanit.

Ndikim dhe gjurmë, në këtë drejtim mbetën edhe nga serbokroatishtja dhe së fundi në masë më të madhe edhe nga anglishtja, e cila sot, duke shkuar drejt globalizimit mund të themi se është bërë gjuhë pothuajse dominuese në botë. “Siç qëndron gjendja në ekonomi, politikë e në fusha të tjera të veprimtarive, me globalizim përfiton më shumë ai që është më i fuqishëm në fushën përkatëse” (Nuhui 2013: 123). Pra, edhe gjuha varet nga zhvillimi ekonomik, teknik, politik dhe ndikohet nga zbulimet dhe zhvillimet e shteteve më të përparuara, përkatësisht gjuhëve që ato flasin dhe shkruajnë.

Huazimet nga turqishtja

Shumë fjalë dhe shprehje që kanë të bëjnë me fushën e ekonomisë, të huazuara nga koha e sundimit të Perandorisë Osmane, edhe ditëve të sotme përdoren me të madhe, madje shumë sosh kanë hyrë me kohë edhe në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe dhe përdoren si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar. Duhet vënë në pah se shumë prej këtyre huazimeve “që kanë hyrë në gjuhën shqipe në shumicën e tyre nuk janë të burimit turk, po janë fjalë arabe e perse të turqishtes” (Çabej 1987: 66).

“Huazimet turke, ose më mirë të themi turqizmat në gjuhën shqipe janë përhapur në disa sfera shoqërore: religjioze ose fetare, administrative, ushtarake – luftarake, të ndërtimit dhe zejtarisë, mjedisit shtëpiak, si dhe të jetës së përgjithshme shoqërore” (Mulaku 1977: 55).

Sidoqoftë, gjurmët e turqishtes janë bukur të thella në gjuhën shqipe dhe prekin të gjitha sferat e jetës, mirëpo punimi në fjalë ka të bëjë kryesisht me fjalët dhe shprehjet në degën ekonomike. Lidhur me këtë Petar Skoku mendon se “ndikimi i kësaj gjuhe i përgjigjet rolit historik

të trefishtë të Osmanllive, si trashëgimtarë të Bizantit, si ndërmjetës midis qytetërimit orientalizatik e Gadishullit Ballkanik, e si kampionët e islamizmit”. Prandaj këtë ndikim ky dijetar e gjen më të fortë “në lëmin e urbanizmit oriental: në esnafë (korporata), në rrugë, në tregti, në ndërtim të shtëpisë, në petka, në formula nderimi etj” (REVUE 1935: 247; Slavia 1937: 166; Përpjekja 1938: 135).

Se sa është prekur dhe ndikuar nga huazimet turke lëmi i ekonomisë dëshmojnë edhe shembujt e mëposhtëm të përzgjedhur nga gjuha e folur ndër ne dhe po ashtu nga përtëritja e turqizimeve përmes shikimit të filmave serik turk, të cilët po emitohen përmes kanaleve tona televizive dhe të cilat në këto raste po i dëgjojmë drejtpërdrejtë vetë. Të tillë janë një numër i konsiderueshëm i emrave të profesioneve të ndryshme të atëhershme, por që edhe sot ushtrohen dhe përdoren edhe në gjuhën shqipe. Disa prej tyre përdoren vetëm në gjuhën e folur dhe janë më të vjetër, ndërsa shumë sosh janë të pranishëm edhe në fjalorët e gjuhës së sotme shqipe, si p.sh.: ahçi (gjellëbërës), abaxhi (zhguntar), çirak, kallfë, kadaifçi (kadaifbërës, ai që bën kadaif), kafexhi, kalemxhi, kalldrëmxi, esnaf, terzi (rrobaqepës), usta, arabaxhi, marangoz, basmaxhi, bazhdari (doganieri), berber, matrapaz, ekmeqaxhi (bukëpjekës), kadi, byrekxhi, bojaxhi, gërçar (poçar), tatlixhi (ëmbëltor), teneqexhi, bozaxhi, çarkaxhi (ai që punon me çark), çifligar, çirak, dajrexhi, dyfekçi (armëpunues), gjevrekçi, gjemixhi (detar), hallvaxhi, hamall, hambarxhi, hanxhi, tezhaxhi (punëtor në tezgë), sërmaxhi (argjendar), bahçexhi (kopshtar), kujunxhi (argjendar, arpunues), kallajxhi, sapunxhi, salepçi, kasap, tyxhar (tregtar), tezgaxhi, zanatli, hyzmeqare (shërbëtores), imam, ulema, hyzmetçi, jamak (ndihmës në punë, kallfë, regrut në ushtrinë e jeniçerëve) jaramaz (i papunë, i llastuar), jazexhi (shkruer, dijetar), rakixhi, shegert, tellall (lajmëtar, zëdhënës), xhambaz (blerës dhe shitës i kuajve), xhamaxhi, xharrah (shërues plagësh; ai që mësonte nga përvoja diçka prej mjekësisë dhe që merrej me operacione të vogla dhe shërim plagësh; ai që bënte synet fëmijët), xhelat, zurnaxhi, qiraxhi,

zabit, daullexhi, qehaja (mbarështues, kujdestar), jorganxhi, kazanxhi, kazaz (zejtar që merret me përpunimin e mëndafshit) etj.

Emra vendesh, objektesh ku zhvillohen veprimtari ekonomike, si: tregtare, bujqësore, zejtare etj: pazar, nahí, hudut, xhade, mejhane, han, mejtep, berberhane, bakallhane, biná, bodrum, çarshi, çylhan (treg, pazar), tezgë, hajrat (vend i shenjtë), hambar, mëhallë, kurt (oborr), mejdan, tophane, qifllëk, baruthane, kasaphane, hamam, gjylestan (bahçe me trëndafil), ilixhe (banjë, ujëra mjekuese), liman (port detar) etj.

Fjalë dhe shprehje shoqërore- ekonomike, si p.sh.: kaull (garanci për mallin e blerë), allëshverësh, ahur, yshyr, zanat, akçe (monedhë argjendi e kohës së Perandorisë Osmane) sermaje (pasuri), kusur, bereqet, terezi, hesap, marifet, masraf (shpenzim), zengjin (i pasur), bollëk, fukarallëk (skamje), kapar, imza (nënshkrim), asqerie, hyqymet, tyxharet (tregti), veresie (hua), yrnek (model, mostër), yshyr (lloj takse gjatë sundimit osman), toptan, shinik (masë drithi prej 25 – 110 okë), defter, taze, hallall, haram, mall, hak, harxh, iftirezhi (spion), borxhli, jallanxhi, kallëp, konak, gjymryk (taksë, tagër), sënduk, zimbil, bajrakli, myhyr, koçi, xhemi (anije), gjytyri (malli ose artikujt që shiten përnjëherë pa u ndarë), hallall mall (mall i vërtetë), haraç, herbab (kursimtar, i zoti) etj.

Disa sosh madje nuk kanë fjalë të përshtatshme në gjuhën shqipe, ndërsa disa prej tyre edhe po të përkthehen e zbehin domethënien dhe kuptimin e qenësishëm të vetë fjalës, meqë kanë hyrë me kohë dhe janë mishëruar me gjuhën shqipe.

Huazimet sllave

Ndikim të dukshëm ka pasur edhe nga gjuha serbokroate në gjuhën shqipe. Të dhënat për sllavët, të cilët formuan shtetet e tyre në mesjetë (bullgare, serbe dhe kroate) dhe pasi pushtuan territoret shqiptare, na japin të kuptojmë ndikimin e pjesërisht të gjuhëve sllave në gjuhën shqipe. Profesor Çabej me të drejtë konstaton se: “marrëdhëniet e shqiptarëve me sllavët, që zgjatën për afërsisht tetë shekuj me

radhë, kanë lënë gjurmën e tyre edhe në gjuhë” (Çabej 1987: 60). Përafërsisht të njëjtën gjë e thotë edhe Jorgji Gjinari se:

“Marrëdhëniet që kanë pasur shqiptarët dhe sllavët e jugut gjatë historisë së tyre kanë lënë gjurmë edhe në gjuhët që ata flisnin. Në krahinat anësore të këtyre popujve kontaktet dhe marrëdhëniet e fqinjësisë kanë vazhduar për një kohë më të gjatë dhe kanë qenë më intensive, prandaj vetvetiu kuptohet se gjurmët në të folmet e atyre krahinave janë më të shumta. Sigurisht për shkaqe të ndryshme, kanë hyrë më shumë elemente nga sllavishtja në shqipen se sa anasjelltas, por nuk janë të pakta edhe faktet që flasin për një dukuri të kundërt” (Gjinari 1966: 157).

Si në çdo fushë të jetës edhe në fushën e ekonomisë dhe në nëndegët e saj të ndryshme si në hotelieri, bujqësi, blegtori etj., prania e sllavizmave është e dukshme edhe për shkak të dygjuhësisë së përdorur në bashkëjetesë me serbët dhe sllavët e tjerë brenda Jugosllavisë së dikurshme, si p.sh.: gostí, gllavinë (bucela e rrotës së qerres), grabitje, govedar (lopar), gradinë (kopsht), grabitçar, pallaçinkë (palëpetë), ikra (vezë peshku), kovaç (farkëtar), çelnic (kryetar i barinjve), kasnec (lajmëtar), kolibe, bodec (hosten), rrobë, bujar, krasit, stan, kantë, lopatë, stol, vadë, brazdë, valanicë, megje (kufi), maticë (amë, amzë), prashit, bravar, vozitës, plaçkë, furkulicë (pirua), temjanicë, porotë, kaish (rryp), kamilicë (kamomil), koritë (shtrat lumi) etj.

Huazimet angleze

Në gjuhën shqipe kemi një vërshim të dukshëm anglicizmesh, veçanërisht të kohës së pasluftës në Kosovë (1999), “huazime angleze për të cilat shqipja nuk ka fjalë të veta, një pjesë të të cilave e përbëjnë huazimet e reja dhe huazimet të cilat i kanë përgjegjëset e tyre në shqipe” (Zymberaj 2011: 207-208), përfshirë këtu edhe huazimet nga fusha e ekonomisë për të cilën po bëjmë fjalë.

“Hapja e gjerë ekonomike e kulturore e Shqipërisë (dhe e Kosovës – mendimi im) ndaj botës në ditët tona ka sjellë edhe një ballafaqim

më të gjerë me gjuhët e mëdha botërore, veçanërisht me anglishten. Rryma e ndikimit të huaj do të gërryejë edhe më tej truallin e fjalës shqipe” (Lafe 1992: 72), thotë profesor Lafe.

Fjalët dhe shprehjet nga lëmi i ekonomisë, të huazuara nga gjuha angleze, edhe pse shumë prej tyre kanë përdorim ndërkombëtar dhe mund të kenë bazë latine, italiane dhe franceze, në Kosovë, kryesisht janë huazuar nga anglishtja. “Një numër syresh tashmë janë pronë e shqipes dhe nuk ndihen si të huaja, dhe siç thotë David Crystal, (në: “The Cambridge Encyclopedia of Language”), “meqë asnjë gjuhë asnjë herë nuk e ka marrë ndonjë fjalë nga ndonjë gjuhë tjetër me qëllim që një ditë t’ia kthejë, e meqë fjalët e tilla kur nuk janë kthyer, termi huazim është term i gabuar” (Caka 2006: 29).

Ja disa sosh, që janë përdorur edhe më herët, në të kaluarën, përdoren edhe sot dhe kanë një përdorim të gjerë ndërkombëtar: taksë, kapital, komercializim, sektor, industri, infrastrukturë, transport, manufakturë, sistem konvejer (sistem i bartjes ose transportit), konsumator, divizion, kompani, auditim, decentralizim, financa, korporatë, union, sindikatë, konditë, profit, donacion, dividendë (interes aksionesh bankare), supermarket, marketing, biznes (punë, afarizëm), bankënotë, devalvim (zhvlerësim i monedhës), inovacione (risi, zbulime), agrikulturë (bujqësi), beneficion, interes (kamatë), manufakturë, sponsor, kreditor, debi, kesh (para të gatshme), kupon, kompeticion, produktivitet (prodhimtari), recesion, hiperinflacion, inflacion monetar, kurbë (lakore), shopping (blerje), kamping (fushim, vendi ku fushohet), agrobiznes etj.

Emra profesionesh: shef, bos, menaxher (udhëheqës, drejtues), supervajzer (mbikëqyrës, kontrollues), IT (ai ti) term për mbikëqyrësin e kompjuterëve në institucion ose firmë, ekonomist, jurist, bankier, profiter (përfitues), diler, akcionar etj.

Në mbështetje të shkrimeve dhe asaj që dëgjojmë në media, disa fjalë dhe shprehje ekonomike angleze përdoren më dendur kohëve të fundit, veçmas në periudhën e pasluftës në Ko-

sovë. Përkundër faktit se kemi fjalë të mirëfillta shqipe nga kjo fushë, përdorimi i huazimeve angleze është bërë i shpeshtë nga profesionistët e ekonomisë dhe auditori i gjerë, të cilët mbase edhe për lehtësi përkthimi përdorin huazimet angleze, pa e lodhur mendjen që të gjejnë ose të përdorin fjalë burimore shqipe, si p.sh: aset (pasuri), promocion (gradim, mbështetje, reklama), oponent (kundërshtar, konkurrent), bono (fletëobligacione, garanci), menaxhmenti i firmës (udhëheqësi e ndërmarrjes), remitancë (dërgesë parash), inpute (përdorim sasior i faktorëve të prodhimit nga ana e një ndërmarrjeje; futje e teknologjive të reja në prodhim), akses (hyrje, rrugë, mundësi hyrjeje), evazion (shmangje), akcizë (taksë indirekte, taksë monopoli), bord (këshill), target (cak, qëllim), stafi i konglomeratit (personeli i ndërmarrjes së madhe), asociacioni i bizneseve të vogla (shoqata e ndërmarrjeve të vogla), proponent (ithtar), alokim i mjeteve (lejim i mjeteve), diversitetet produktesh (laryshi ose llojllojshmëri prodhimesh), stoqe, brende (lloje, tipe), risk (rrezik), resurse (burime), fifti-fifti, tender, suport (mbështetje), broker (ndërmjetësues), barelë (bucelë, fuqi, rezervuar) deficit buxheti, privatizimi, politikë fiskale, depresion ekonomik (krizë ekonomike), damping (shitje e mallrave në tregun e huaj nën çmimin e kostos së tyre), bilans etj.

Përfundim

Përdorimit të fjalëve të huaja nuk mund t’i vejmë kufi, ato shfaqen me kohën dhe nevojën për përdorim tek shumë gjuhë, po ashtu edhe në shqipen. Në pajtim me këtë profesor Lafe shprehet kështu: “Zhvillimi i gjuhës nuk mund të pengohet. Gjuha zhvillohet bashkë me shoqërinë, me ekonominë e vendit, të rajonit e të botës. Çështja është që gjuha të mirëmbahet, të mbarështohet, pra të jetë nën një kujdes shoqëror e shpirtëror të vijueshëm” (Lafe 2013: 23).

Mendoj se, gjithnjë duhet kushtuar vëmendje dhe duhet kërkuar mundësi e rrugë për ta kultivuar, pasuruar dhe mbrojtur gjuhën shqipe, përkundërt faktit se ndikimet e gjuhëve

të përmendura më sipër kanë lënë gjurmë të thella.

“Elementet gjuhësore barten prej një gjuhe në tjetrën edhe për shkak të prestigjit që e gëzon e para. Gjuha angleze, për shkak të pozitës ekonomike, politike dhe kulturore të Britanisë së Madhe, sidomos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, bën trysni për depërtimin e elementeve të saja gjuhësore në shumë gjuhë europiane dhe jashtëeuropiane. Prandaj, në këtë pikëpamje nuk ka ngelur anash as gjuha shqipe” (Nuhui 2013: 24).

Sa i përket terminologjisë teknike, e cila në gjithë botën është më e re në historinë e leksikografisë krahasuar me terminologjitë e degëve të tjera të shkencës dhe se shumë popuj e përdorin pothuajse fjalën e njëjtë nga kjo fushë d.m.th., pa e përkthyer fare, si p.sh.: makinë, automobil, aeroplan, inventar, kompjuter, akesor, telefon mobil, vokmen, disk, aparat, instrument, radio, televizion, sintisajzer etj. Për disa syresh ende nuk kemi fjalë të formuara të përshtatshme shqipe dhe se prej kohësh i përdorim ashtu si i dëgjojmë, për disa të tjera jemi në përpjekje për të gjetur mundësi që t’i përkthejmë në gjuhën tonë. Ka edhe të përkthyerat ose edhe kanë mbetur në përdorim nga kanë buruar prej kohësh.

Kur kemi parasysh gjithë këto ndikime të jashtme duhet pasur vëmendje të shtuar dhe duhet bërë çmos për mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe mundësinë e përkthimit të përshtatshëm të fjalëve dhe shprehjeve ekonomike në këtë rast, me përqendrim të vullnetit dhe të forcave mendore, në përpjekje të krijimit të fjalëve të reja dhe të

mirëfillta shqipe, ashtu siç bëjnë shumë popuj të civilizuar për mbrojtjen dhe respektimin e gjuhës së vet amtare, gjithnjë duke e pasur parasysh ndjenjën e përgjegjësisë profesionale dhe gjuhësore.

Bibliografia

NUHIU, Vejsel (2013), *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë.

ÇABEJ, Dr. Eqrem (1987), *Studime gjuhësore III Rilindja*, Prishtinë.

MULAKU, Latif (1977), *Turqizmat në gjuhën shqipe: “Seminari i kulturës shqiptare për të huaj” 3*, Prishtinë.

REVUE Internationale des Études balkaniques I (1935), SLAVIA XV (1937) 166 vv.; PËRPJEKJA shqiptare 2 (1938) 135 vv.

GJINARI, Jorgji (1966), *Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë jugore: “Studime Filologjike” 2*, Tiranë.

ZYMBERAJ, Prof. Dr. Xheladin (2011), *Shqipja standarde dhe pastrimi i saj nga fjalët e huaja: “Java e Shkencës”*, Prishtinë.

LAFE, Emil (1992), *Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot” Tiranë, 20 – 21 nëntor.*

CAKA, Nebi (2006), *Huazimet leksikore dhe qëndrimi ndaj tyre: “KOHA për kulture” Nr. 324, 29, të së përditshmes “Koha Ditore”, nr. 3339, Prishtinë, 30. X 2006.* <http://www.peshkupauje.com>.

LAFE, Emil (2013), *Gazeta Shqiptare, 7. Korrik, Tiranë.*

PERSONAZHI SATIRIK DHE QESHARAK NË ROMANIN “KARRIERA E ZOTIT MAKSUT” TË QAMIL BUXHELIT

THE SARCASTIC AND RIDICULOUS CHARACTER IN THE NOVEL “THE CAREER OF MISTER MAKSUT” OF QAMIL BUXHELI

VJOLLCA RRAPAI

Departamenti i Letërsisë, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Shqipëri
Email: vjollcarapai@yahoo.com

AKTET VII, 3: 227-231, 2014

PËRMBLEDHJE

Qamil Buxheli është një ndër shkrimtarët modernë të satirës dhe humorit në letërsinë shqipe. Me krijimtarinë e tij letrare, Buxheli e pasuroi letërsinë tonë me mbi njëzet vëllime, përmbledhje me tregime, fejtone, romane, drama, novela. Subjekti i romanit *Kariera e Zotit Maksut* është i thjeshtë: Maksut Ramo është kryetari i komunës së Tarinës, por ëndrra e tij diplomatike për t’u bërë konsull bëhet objekt humorit e satire. Maksuti shfaqet në vepër si një personazh kompleks dhe real, si një njeri pa personalitet, servil dhe frikacak, ambicioz dhe i paaftë, krenar dhe sqimatar. Romani *Kariera e Zotit Maksut* zbulon elementët jetësorë nëpërmjet përshkrimit të ngjarjeve në komunën e Tarinës. Autori e pasuron veprën e tij me situata të shumta komike, kontradiktore dhe nëntekste të pasura satirike. Kumtesa sjell ndihmesë në studimin e personalitetit krijues të Qamil Buxhelit, në studimin e prozës shqipe dhe në historinë e letërsisë shqiptare.

Fjalët çelës: roman, satirik, ëndrra diplomatike, servile.

SUMMARY

Qamil Buxheli is one of the modern writers of satire and humour in Albanian literature. He enriched our literature further with his works comprising over twenty volumes, feuilletons, novels, dramas, novelettes etc. The subject matter of the novel *The career of Mister Maksut* is simple; Maksut Ramo is the mayor of the commune of Tarina, his diplomatic dream to become consul becomes object of humour and satire. Maksut is revealed in the novel as a complex and real character, a man without personality, servile, coward, ambitious and incompetent. The novel *The career of Mister Maksut* manifests the vital elements through the description of the events in the commune Tarina. The author enriches his work with numerous comical and contradictory situations rich in satirical subtext. The article is a great help in the study of creative personality of Qamil Buxheli, in the study of Albania prose and history of Albania literature.

Key words: novel, satirical, diplomatic dreams, servile.

HYRJE

Në këtë punim synohet të bëhet një analizë e detajuar mbi romanin satirik *Kariera e zotit Maksut* të shkrimtarit Qamil Buxheli. Buxheli është autor i romanit të parë satirik shqiptar dhe me penën e tij pasuroi gjininë e prozës sonë edhe me zhanrin humoristik, satirik e grotesk. Arsyet që na

shtyjnë të merremi me studimin e të këtij romani janë personazhet e tij të veçantë, situatat humoristike dhe satirike që autori i sjell me mjaft mjeshtëri. Buxheli nëpërmjet këtij romani përcjell situata komike dhe satirike gjatë zbërthimit që u bën personazheve, të cilët duke karakterizojnë e përgjithësojnë shumë dukuri dhe

tipa që shfaqen në periudha të caktuara historike. Personazhet e Buzhelit janë të angazhuar me seriozitet në punët e në shqetësimet e tyre të përditshme, ata nuk bëjnë shaka dhe nuk do të praninin kurrsesi se janë qesharakë, por sjelljet e tyre i bëjnë të tillë.

2. Ëndrra diplomatike e zotit Maksut

Romanin satirik *Kariera e zotit Maksut*, për lexuesin shqiptar e sjell në vitin 1971 nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri". Romani është cilësuar si një nga veprat më të suksesshme të shkrimtarit Qamil Buxhelit. Objekt të satirës, humorit dhe shakasë në këtë vepër Buxheli bën kryetarin e komunës së Tarinës, postkomandantin Kalosh, nënprefektin, bujkun Zenjel Beu, tregtarin Mihal dhe disa personazhe të tjerë, ku përmes humorit të këndshëm autori tallet me sjelljet dhe injorancën e tyre.

Maksut Ramo emërohet kryetar komune në Tarinë me shpresën e madhe se me ndërhyrjet e të atit do të mund të siguronte një post si konsull apo kryekonsull jashtë vendit. Kjo ëndërr i kishte lindur gjatë dështimit që kishte pasur në kohën kur kryente studimet e larta për tregti në Selanik. Duke parë dajën e tij (i cili kishte vetëm tri klasë shkollë) shpresonte që edhe ai një ditë do të bëhej i suksesshëm edhe pa pasur arsimin e duhur.

Ditën e parë të punës në Tarinë, ai u njoft me plogështinë dhe qetësinë me të cilën jetonin banorët jetën e përditshme. Si për çudi zoti Maksut ndjente frikë dhe pasiguri për të ardhmen e tij e mbi të gjitha ndjente pasiguri për realizimin e ëndrrës diplomatike. Ditët kalonin dhe kryetari i ri po ambientehej me mjedisin dhe qetësinë vrastare të Tarinës. Më tepër se kudo tjetër plogështia në Tarinë binte në sy në praktikën zyrtare, në korenspondencën e komunës me instancat më të larta qeveritare. Letrat aty mbërrinin me shumë vonesë dhe herë – herë në destinacion të gabuar. Shpesh herë zoti Maksut argëtohej me mesazhet apo urdhrat që ato përcillnin, por sa më tepër që koha kalonte aq më shumë po zbehej ndikimi i të atit në rrethet qeveritare pas falimentimit të tij në fushën e tregtisë. Miqtë e të atit e mbanin gjithmonë me shpresë se kriza nuk

do të zgjaste gjithë kohës, se do të vinte patjetër një ditë e bardhë edhe Maksuti do të realizonte "ëndrrën e tij diplomatike". "Me këtë shpresë, kryetari i komunës së Tarinës shtynte ditët, netët, muajt, vitet. Me ankth të madh priste ai, sidomos ditën e postës. Gjithnjë i bëhej në ëndërr zarfi magjik "rezervat" me vulën e ministrit që s'vinte kurrë. Sa herë binte zilja e telefonit, ai dridhej i tëri, emocionohet: "Ku ta dish mendonte, mund të jetë minuta e siariqit të madh!.." (Buxheli 1971: 9).

Zoti Maksut zhvillohet e rritet në mjedisin ku jeton, në shoqërinë e parisë së Tarinës, me të papriturat që sjell çdo ditë e kaluar atje. Gjatë qëndrimit të tij në Tarinë, Maksuti rendësi të veçantë i kushton oksidentalizmit të njerëzve duke u mësuar atyre shprehje të bukura, kërcime dhe muzikë perëndimore. Por, shpresat për realizimin e ëndrrës së tij mundehej t'i gjente kudo dhe shpesh herë fatin e tij ai e kërkonte edhe në letrat e bixhozit apo në bastet që bënte me veten në situata të ndryshme: "ai vuri një bast të ri me veten: "në qoftë se fitoj edhe këtë herë, do të thotë se ëndrra ime diplomatike do të vihet shpejt në jetë. Në rast se jo... - Ç'letër e ndyrë! Shfryu kryetari." (Buxheli 1971: 29).

Një situatë të tillë Buxheli e sjell me mjeshtëri tek lexuesi pak çaste përpara se të lajmërojë mbërritjen e dy Zyberve në Tarinë. Lajmi se një person tjetër është emëruar kryetar komune në Tarinë, zgjon edhe një herë shpresën e humbur pak çaste më parë tek zoti Maksut. "Më në fund"-mendoi duke u munduar të linte përshtypjen se nuk po i jepte ndonjë rendësi të veçantë çështjes. "Përderisa një njeri vjen të më zëvendësojë, do të thotë se unë jam transferuar!" Ai deshi një herë të ndërpriste lojën dhe të merrte vesh sa më parë se si qëndronte puna. Por, mendimi se kishte vënë me vete një bast, të cilin deri tani e kishte humbur, e gozdoi në vend. "Jo! - tha me vete. – të mbaroj edhe këtë dorë dhe ta fitoj patjetër. Përndryshe, dreqi e di, mund të marr ndonjë lajm të hidhur" (Buxheli 1971: 30-31).

Nuk mundi ta çonte deri në fund lojën e tij zoti Maksut, sepse pretendenti për postin e kryetarit, Zyber Duka donte të kurorëzohej sa më shpejt në postin e tij. Zoti Maksut verifikoi se gj-

thçka ishte në rregull, tani shqetësimi i vetëm ishte emërimi i tij. “Ku do të ishte emëruar vallë...?!”. Nuk arriti zoti Maksut të përfundonte bashkëbisedimin me Zyber Dukën në lidhje me emërimin e tij të ri, kur në derë shfaqet një tjetër Zyber si pretendent për kryetar komune. Mes të treve krijohet një situatë konfuze dhe qesharake për postin e kryetarit, sepse të dy pretendentët kanë dokumentat e duhura. E gjithë kjo situatë do të merte fund vetëm falë shpjegimeve të nënprefektit se një tjetër Zyber, Zyber Muka ishte emëruar kryetar në komunën fqinje, në Marinë, ndërsa e gjithë ngatrra mes Zyberve kishte ndodhur si pasojë e një pakujdesie të sekretarit të ministrit, sepse në makinën e tij të shkrimit mungonte shkronja “m” dhe ky i fundit në vend të saj kishte përdorur shkronja të tjera.

Në kreun e dytë të romanit autori i bën edhe më tepër kureshtar lexuesit, mbi fatin e Maksutit pas letrës urgjente të ministrit të brendshëm, i cili njoftonte për vizitën e historianit të njohur David Jakobson në Tarinë. Letra e udhëzonte zotin Maksut për të gjitha detajet e organizimit që duhet të kryente. Shqetësimin e Maksutit, autori e paraqet nëpërmjet ankthit, veseve, depërtimit në psikologjinë dhe botën e brendshme. Në fund të letrës autori, jo pa qëllim vendos një “Post script”, ku ministri i shkruan zotit Maksut se lutjet e tij për t’u emëruar konsull apo kryekonsull janë marë gjithmonë parasysh dhe se tani çdo gjë do të varej nga kurorëzimi me sukses i pritjes së historianit.

Për të diskutuar mbi pikat e organizimit të pritjes së personalitetit botëror Maksuti shkon në prefekturë, por për shkak të një keqkuptimi, ai hyn gabimisht në zyrën e nënprefektit dhe dëgjon këshillat e tij për të birin, mbi artin e të shtirurit. Nënprefekti, i cili gjatë gjithë kohës që bisedonte me të birin qëndronte me kurriz e këshillon në këtë mënyrë: “çdo njeri ka dy njerëz: njëri ai që duket, tjetri ai që është në të vërtetë, po që nuk duket gjithnjë e nga të gjithë. Në këtë botë, harisëz, fiton ai që di të duket e të shtiret”. (Buxheli 1971: 46). Nga e gjithë “biseda” mes prindit dhe fëmijës zoti Maksut kupton se sjelljet e nënprefektit ndaj të tjerëve janë vetëm shtirje, se edhe ai vetë duhet ta mësojë artin e të shtirurit.

Ndoshta e gjithë kjo mund ta bëjë atë edhe më të suksesshëm në sytë e epurve të tij.

Biseda mes dy zyrtarve zhvillohet rreth pritjes së historianit dhe buxhetit të vënë në dispozicion. Përpara eprorit të tij kryetari ynë shfaqet i përlulur dhe i gatshëm, ai i pranon të gjitha sugjerimet dhe urdhrat e tij pakundërshtuar asgjë.

Mes shumë përgatitjeve që duhet të kryente zoti Maksut për pritjen e historianit të dëgjuar, ai duhej të angazhohej edhe në realizimin e “skenografisë” për sistemimin e popullit në shesh dhe në mënyrë të veçantë ai duhej të kujdesej që ata të dukeshin sa më të lumtur e të bukur në sytë e Jakobsonit. Përpara mbërritjes së historianit, zoti Maksut inaguroi veprën e tij më të madhe të ndërtaur në territorin e komunës “Nevojtoeren publike”. Ndërtimi i saj sipas Maksutit tregonte modernizim dhe emancipim, por më e rendësishmja ishte fakti se tani banorët e Tarinës nuk do t’i kryenin më nevojat e tyre poshtë dritares së kryetarit.

Për kritikun Hasan Hasani, Buxheli ironizon e tallet me ëndrrën diplomatike të Maksutit. Ai shprehet se: “Zotin Maksut, Q. Buxheli e vë në pozita të ndryshme dhe qesharake duke mos kursyer asnjëherë ironinë e cila arrinë në sarkazëm. /.../ Buxheli për të treguar se kush është ky dhe në çfarë vendi punon dhe se a ka mundësi që prej këtij vendi, prej kësaj komune, në qoshen e së cilës fëmijët dhe njerzit e rritur kryenin nevojën e urinës, nën dritaren e zotit Maksut, sepse kjo është një komunë pa nevojtoere publike – ironizon shkrimtari, këput njëherë e përgjithmonë të gjitha shpresat, që një njeri i tillë siç është zoti Maksut, vërtet nuk ka vend askund” (Hasani 1972: 7,8).

3. “Etja” e tarinësve për të hyrë në histori

Buxheli nëpërmjet këtij romani përcjell situata komike dhe satirike gjatë zbrërthimit që u bën personazheve të tij. Ardhja e historianit të dëgjuar në Tarinë shërben për të njohur më mirë edhe pjesën tjetër të personazheve në vepër. Si për çudinë e të gjithëve David Jakobson dhe shoqëruesi i tij Karafili mbërritën në Tarinë një muaj e gjysëm më shpejt nga sa pritej, pikërisht ditën kur zoti Maksut po inaguronte “nevojtoeren

publike” dhe përpiquej të kuptonte se ç’impakt do të kishte fjalimi i tij në popull.

Përpara mbërritjes së tyre në Tarinë, Buxheli duke dalë nga skema tradicionale e mbajtjes së lexuesit në tension për rolin apo të fshehtat e disa personazheve, vendos të na rrëfejë që në fillim se personalitetet që pritet të vijnë nuk janë gjë tjetër veçse dy mashtrues, të cilët kishin dëgjuar më parë për vizitën e historianit të njohur në Tarinë. Njëri prej tyre është Karafili, biri i një tregtari të dëgjuar, që i velur nga të mirat e jetës kërkon ku e ku të mundet aventurën. Ai shfaqet në Tarinë në rolin e përkthyesit të historianit, por paharruar të flasë edhe për lidhjet e tij familjare me ministrin e brendshëm. Në të vërtetë ai është vetëm një mashtrues, që së bashku me shokun e tij francez Rozhe Antoan, që këtu shtiret si historian, përpiquej të përfitojnë të mira matriale sa herë që të munden e kudo që të munden.

Karafili, që e njëjtte mirë mentalitetin e shqiptarëve e udhëzon shokun e tij për mashtrimin e radhës, ai është në gjendje të kalkulojë çdo gjë, çdo detaj. Autori ka bërë një gjetje interesante me personazhin e Karafilit, jo pa qëllim i ka vendosur edhe këtë emër, sepse i tillë është edhe në veprimet që bën, ai depërton bukur në psikologjinë e parisë së Tarinës dhe “viktimize” të tjera.

David Jakobson vinte në Tarinë me mision për të shkruar historinë e xhajës së mbretit, për të njohur nga afër bashkëkohësit dhe vendin ku ai u burgos. Pasi u prezantuan me kryetarin dhe parinë e vendit, Karafili dhe shoku i tij përgëzuan zotin Maksut për mikpritjen dhe i kërkuan të mos kishte ceremonira të zgjatura. Historianit i interesonin më tepër takimet dhe vizitat me njerëzit e fisëm, me qëllim që të njëjtte kontributet dhe vlerat e tyre më mirë: *“Sqarimi i “nipit të ministrit” shkaktoi një kënaqësi të ligjshme dhe ngjalli shpresa të mëdha midis njerëzve të parisë, të cilët gjatë atyre katër muajve e gjysmë kishin gëdhirë net të tëra pa gjumë, duke vrarë mendjen, duke trilluar qindra legjenda me anën e të cilave shpresonin të tërhiqnin vëmendjen e historianit të dëgjuar dhe të siguronin oxhaqeve të tyre një vend modest në tekstin e historisë së Lartëmadhërisë...”* (Buxheli 1971: 122-123).

Karafili i njohu krerët e Tarinës me parimet e historianit, si të ishte një mik i tyre i vjetër, se dëshira e tij ishte të drekonte e darkonte tek të gjithë dhe si një njohës i zakoneve shqiptare ai i pranon e vlerëson dhuratat dhe peshqeshet e mëdha e të vogla. Krerët e Tarinës të etur për lavdi vrisnin mendjen për dhuratën e duhur dhe vendin që do të zinin në histori.

Zenjel Beu ishte njëri prej tyre, që donte patjetër të ishte në krye të histories, edhe pse nuk ka ndonjë post shtetëror, ai luan rol të rëndësishëm në vendimet që merr kryetari i komunës për shkak të miqësive të tij në kryeqytet. Zenjel Beu shfrytëzonte bujqit dhe nënpunësit e qeverisë për të përfituar të mira matriale. Ai ishte i pari që mikpriti historianin dhe Karafilin në shtëpinë e tij. Zenjel Beu ishte gjithmonë në garë me Mihalim, tregtarin më me zë në Tarinë.

Karafili argëtohet dhe tallet me ëndrrën diplomatike të zotit Maksut, dëfrehet pafund me gratë e Zenjel Beut dhe xhvat çfarë të mundet nga kushdo në Tarinë e përreth. Gjatë qëndrimit të visitorëve në Tarinë autori sjell para lexuesve situata të shumta satirike e qesharake, siç ishte rasti i takimit të historianit me tre pleqtë bashkëkohës të xhajës, vizita gjatë një dite pune në komunë dhe në burg për të parë nga afër një ditë pune atje. Vizitorët lavdërojnë pafund drejtuesit vendorë për vigjilencën dhe mikpritjen, ju premtojnë se do të bëjnë gjithçka që ata të arrijnë poste me të larta drejtuese. Pas përfitimeve të shumta Karafili dhe shoku i tij lagohen nga Tarina me të marrë vesh se historiani i vërtetë është nisur drejt saj.

Një vend të rëndësishëm në roman luan edhe rrëfimtari, rolin e të cilit e kryen vet autori, duke na i paraqitur edhe më të gjalla situatat komike e qesharake. Figura e hiperbolës haset shpesh në vepër siç është rasti i vetburgosjes së mjekut të kafshëve, zotit Kokoshi, i cili shfaqet vetëm në kapitujt e fundit të veprës. Ky personazh vjen tek lexuesi fillimisht si njeri pa logjikë, por bindjet e tij realizohen në fund të romanit, kur paria e Tarinës i japin të drejtë dhe bëjnë gjithçka për të qenë përkrah tij të vetburgosur, duke pritur çlirimin nga ushtria italiane, në këtë mënyrë përfundon romani *Kariera e zotit Maksut*.

Aventurat e personazheve tanë Buxheli i zhvillon më tej në romanin *Maratona e vdekjes*, por ky roman meriton një tjetër studim.

4. Përfundime

Objekt i atudimit tonë është personazhi satirik dhe qesharak në romanin *Kariera e zotit Maksut*. Humori, satira, grotesku dhe thjeshtësia janë disa nga tiparet kryesore të individualitetit të letrar të Qamil Buxhelit, këto tipare e bëjnë atë origjinal dhe të veçantë. Buxheli është një ndër përfaqësuesit kryesorë të prozës shqipe që spikat sidomos me tregimet dhe romanet e tij satirike. Ajo që bie në sy në krijimtarinë e tij është humori dhe satira me të cilën, vuri në lojë vetitë dhe veset negative të disa individëve për të cilët shkroi. Ne u përpoqëm të sjellim një panoramë të personazheve në romanin *Kariera e zotit Maksut*, "heronjtë" e të cilit duan të duken ndryshe nga ç'janë. Autori tallet me ta përmes situatave komike të jetës së përditshme. Ardhja e historianit të dëgjuar në Tarinë shërben për të njohur më mirë edhe pjesën tjetër të personazheve në vepër. Ky roman shquhet për veçanti

dhe origjinalitet, për galerinë e zgjedhur të personazheve, si dhe situatave të shumta qesharake e satirike. Synuam të evidentojmë disa karaktere hipokrite, që ndryshe flasin e ndryshe veprojnë

Bibliografi

- AGOLLI, Dritëro (2004), Një personalitet i shquar i kulturës dhe letërsisë së re shqiptare (Shkrimtari Qamil Buxheli): "*Zëri i popullit*", nr. 48, 30 maj.
- BUXHELI, Qamil (1971), *Kariera e zotit Maksut*. Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë.
- BUXHELI, Qamil (1974), Mbi disa çështje të satirës dhe humorit: "*Drita*", 31 mars: 3-4.
- HASANI, Hasan (1972), Romani *Kariera e zotit Maksut* i Qamil Buxhelit: "*Fjala*", Prishtinë, nr. 9, shtator: 7, 8.
- HYSO, Riza (1972), Mbi dy romane satirike... "*Kariera e Zotit Maksut*": "*Drita*", 24 dhjetor: 6, 8.
- JAKUPI, Mato (1972), *Veçori të epizmit satirik* (shënime mbi romanin) "*Kariera e Zotit Maksut*": "*Nëndori*", nr. 10: 12-20..

SHQYRTIME ONOMASTIKE DHE SOCIO-ETNOLINGUISTIKE NË TË FOLMEN E MATIT

ONOMASTICS AND SOCIO-ETNOLINGUISTIC REVIEWS IN THE DIALECT OF MATI

MERITA HAS-HYSAJ, ZAMIRA HAVAJA
Email: ritahysa1@gmail.com; zamirahavalja@hotmail.com

AKTET VII, 3: 232 - 237, 2014

PERMBLEDHJE

Punimi synon paraqitjen e gjendjes dhe zhvillimit të disa dukurive më të spikatura në fushë të etnografisë së të folurit dhe onomastikës së Matit. Interesi ynë është fokusuar në hulumtimin dhe shqyrtimin e emrave familjarë dhe sinonimisë së tyre; në përshëndetjet tipike të krahinës; si dhe në përimitësimin e veçorive strukturo-semanticke që paraqet toponimia e Matit. E folmja e Matit, krijon një oazë të veten në mënyrën e emërtimit të emrave të farefnisës; një ndër prirjet e sotme të të shprehurit të përshëndetjes në gjuhën shqipe, krahas efektit globalizues e huazues, shkurtimit e turrjes së asaj ekzistuese, zëvendësimit dhe shmangies, shihet tendenca e re e të rinjve për të pakësuar dhe varfëruar modalitetet e pasura të shprehjes së saj. Toponima e Matit është një vjimësi, në kuptimin që ajo qoftë në aspektin semantic, strukturor, dëshmon përbashkësi dhe njëllojshmëri me toponiminë shqiptare.

Fjalët çelës: dialekti, përshëndetjet, etnografi të foluri, toponimia, studime.

SUMMARY

In this work, our goal is to present an overview of the present situation and the development of some of the most remarkable phenomena in the field of ethnography of speaking and onomastic of Mati Dialect. Our interest is focused on the research and review of family names and their typical greetings, as well as the characteristics of semantic structures featuring Mat toponymy. It is worth noting that, the dialect of Mati, creates an oasis in his way of naming the names of kinship; one of the trends of current's expression of greeting in Albanian language, has been seen in the young generation to reduce and impoverish the rich modalities of greeting expression in our language. Mati toponyms treated as an integral part of the overall macrostructure of Albanian toponomy, is a continuation of it, because in its semantic, structural aspect, it proves fellowship and equal treatment.

Key words: dialect, greetings, ethnography of speaking, toponymy, studies.

Hyrja

Sociolinguistika ka bërë shpeshherë dhe vazhdon të bëjë objekt të saj të studimit, marrëdhëniet që vendosin njerëzit mes tyre të materializuara në gjuhë, qoftë ajo një variant me prestigj apo dialektor. Si e tillë, dukuri që lidhen me kulturën, shoqërinë, etninë, i rrok në gamën e gjerë të problematikës së vet. Në këtë hulli trajtimi, jemi ndalur shkurtimisht në tre aspekte:

(a) Sinonimia e emrave familjarë në të folmen e Matit

Sinonimia e emrave familjarë dhe të farefnisës është një dukuri që paraqet shumë interes dhe që është e lidhur me shtresat kulturore, shoqërore e krahinore, njohja dhe shqyrtimi i të cilave shpie në pikëtakime interesante mes mënyrës së të menduarit dhe mënyrës së emërtimit të shumë fjalëve në zona a treva të ndryshme.

Problematika që shtrun kjo fushë, i takon asaj të trysnisë së vazhdueshme shoqërore dhe kulturore mbi gjuhën. Më saktë, është një fushë ku gjuhësorja dhe shoqërorja ndërthehen me

mundësi përkimi dhe përqsasje këndellëse, sidomos përsa i takon emrave të njerëzve, zbulimeve apo trajtave të dyta përkëdhelëse me shkurtime apo prapashtesa të ndryshme, që i ndeshim aq dendur kudo nëpër trevat tona (e kësaj shpërfaqen edhe në krahinën e Matit), pastaj në emërtime sinonimike shumë të larmishme për lidhjet a marrëdhëniet e farefisnisë, përgjithësisht të lidhjeve familjare, martesore, gjinore etj. Krahas lidhjes me një mendësi kulturore apo shoqërore të caktuar, që ngushtësisht kufizohet në një zonë të përbashkët, vlen të thuhet se kjo dukuri në planin gjuhësor apo dhe të prejardhjes semantike, ndërton një deltë të gjerë sinonimike, e cila shfaqet si prirje specifiki dhe përcaktimi në emërtim (Shkurta: 2001: 144).

Por, nga një trevë në tjetrën, e madje edhe brendapërbrenda jo rrallë, vihen re dallime, po aq sa ç'përvijohen të përbashkëtat brenda entitetit. Kjo më tepër se me faktorë të tjerë, duhet të lidhet me mendësinë përbashkuese të grupimit folës.

Duke sjellë material dhe të dhëna konkrete nga e folmja e Matit, për dukurinë në fjalë do të përmendim se këtu, për fjalët shqipe standard: **vjehërr, vjehërra** kemi sinonimet: **baba i nuses, nana e nuses, krushku, krushka, meku, meku i shpajs, e ama e nuses**; ndërsa sa i përket farefisit të nuses quhen '**prent**' d.m.th. familja e prindërve të saj: *ka shku nusja ke prent, e kam çu n'pren t'vet*. Vajza që martohet dhe del nga shtëpia quhet **bi**: ose **bija e shpajs**: *ku s'merr bija e merr vija*.

Nusja e djalit quhet **re-reja** ose **nusja**, ndërsa ajo i thërret prindërit e djalit: **nân, bâb** ose **tête, la:l**; në jo pak raste sot dhe me format e reja "*të moderuara*" **ma, ba**. Ka madje raste, kur i thërret me emër të tyre, ashtu siç mund t'i thërresin vetë djali ose fëmijët e tjerë.

Ndërsa për djalin, kur shkon tek shtëpia e nuses thonë: *ka shku ke prent e grus, ka shku ke miç / mijtë, ose ka shku ke dajat a prent* kur i jepen nuanca talljeje dhe humori. Për fjalët **gjysh** e **gjyshe** të standardit kemi: *nanbija, nanmadhja, nanloke*. Për izoerget që u takojnë fjalëve të farefisnisë + emrat vetjakë, themi se për krahinën

tonë shkon ndarja e tipit: togjet e përbëra me emrat e farefisnisë a lidhjeve të tjera familjare në trajtë të pashquar + emrin vetjak në trajtë të shquar, p.sh.: *hall Tana, teze Fatimja, dajë Aliu, mixh Abazi*.

Problemit të marrëdhënieve midis bashkëmoshatarëve, prindërve a fëmijëve, rejave e vjehrrave dhe, në krahinën tonë i mbështillet njëlloj eufemizmi, sidomos vjen e theksohet përsa i takon emrit të burrit të thënë nga ana e gruas dhe anasjelltas, dukuri që njihet dhe si "*tabu*". Kjo nuk besojmë të jetë për mungesë kulturore apo shenja të inferioritetit, por më shumë një **traditë e ngulitur thellë**.

Kështu në situata, të kësaj natyre mund të përdorin njësi të tilla gjuhësore: *ai ose aj, yt at', t'at, baba yt, taj, ortaj, ëj, me té e kam, a e ngjëve, thuj babës tyt, o njeri, o plak*. Ka raste kur e thërresin njëri-tjetrin edhe me emër të fëmijës për të dëgjuar respektivisht secili. Një mënyrë tjetër për të thirrur gratë nga ana e burrave është dhe ruajtja e mbiemrit të vajzërisë së saj: *Toçe-ja* (emrin e ka Shkurte), *Bushe* (Sanie), *Kolece-ja* (Vale), *Vatdode* (Behare), *Mixhoze-ja* (Vera) etj.

E folmja e Matit në këtë drejtim krijon një oazë të vetën për nga mënyra e emërimit të emrave të farefisnisë. Themë që ka pikëtakime me zonat fqinje domosdo. Kjo e folme, gjithashtu i përdor këto trajta edhe si forma të respektit ndaj njerëzve me status apo moshë të shkuar: *nân, ij-e, ha:ll, xhaxha, mi:xh, da:xh* etj.

Përsa i takon filtrimit fonetik të emrave të hyrë në shqipe në kuadër të ndikimit të huaj, apo të besimeve dhe praktikave fetare, kjo e folme nuk paraqet dallime specifike. Këtu, dallimet janë shumë të vogla, për të mos thënë që nuk ekzistojnë, pasi popullsia e Matit është homogjone, e në këtë drejtim e folmja shkon në të njëjtin kah me gjithëgjuhën.

(b) Përshëndetjet në zonën e Matit

Përshëndetja është akt social dhe individual që përdoret në të gjitha shoqëritë njerëzore si pikënisje për të vendosur kontakte njerëzore a komunikuese me tjetrin. Njeriu, në dallim nga çdo krijesë tjetër, është i detyruar si qenie sociale të shoqërizohet dhe të vendosë marrëdhënie me

njerëz të tjerë në gji të bashkësisë ku jeton. Ndër këto më specifiket janë marrëdhëniet mbi bazë respekti, mirënjohje, dashamirësie, kulture etj. Që në mëngjes dhe përgjatë aktivitetit a veprimtarisë së ditës, njeriu përfshihet në qerthull sjelljesh e shkëmbimesh ndërvetjake, të cilat në kohë janë bërë stereotipe e, madje gati-gati të vetvetishme, por që nisin të gjitha me një përshëndetje (Shkurtaj 2001: 196).

Përshëndetja pasqyron një traditë të lashtë sa vetë njeriu, d.m.th. të drejtuarit me fjalë dhe nisjen e një komunikimi të vërtetë midis dy vetave. Ajo është pikënisje për komunikim, prandaj ka edhe një funksion të rëndësishëm gjuhësor. Edhe vetë përdorimet e fjalëve për të transmetuar përshëndetjen, kanë ndryshuar, janë pasuruar dhe përtërirë, jo vetëm brenda grupit a ndërmjet grupeve, por madje tek vetë personi a individët pjesëmarrës në këtë aktivitet gjuhësor.

Në traditën tonë, si një popull i lashtë e kulturëdashës, kanë ekzistuar forma të shumta e të ndryshme përshëndetjeje për çdo lloj kohe, rasti, feste e gëzimi.

Akti i parë i përshëndetjes është dhënia e dorës së djathtë personit me të cilin takohet, kjo parakupton nderim, respekt dhe shenjë paqeje mes tyre, sadoqë tani është thjesht një gjest simbolik mekanik i uniformizuar për kulturën tonë. Më mirë se kudo, në rastin e përshëndetjes vlen të përdoret parimi sociolinguistik i Fishmanit: "*Kush flet, me kë, kur, për çfarë dhe në cilin varietet?*".

Përshëndetja synon të pasqyrojë sa më mirë faktorët e ndryshëm sociolinguistikë: *numri i bashkëbiseduesve, vendi ku kryhet, moshë, gjinia, marrëdhëniet shoqërore dhe roli a statusi i bashkëfolësve, lloji i përshëndetjes, kanali i transmetimit të përshëndetjes, përdorimi i regjistrave të ndryshëm etj.*

Sipas vaktit, punës, festës, ditëve të rralla, lindjeve, vdekjeve, martesave e gëzimeve, shkëmbimet dhe takimet me të tretë a të panjohur, po përmendim disa situata të jetuara, a të tjera të mbledhura në gojën e brezit të tretë, që shënojnë raste përshëndoshje,

përgëzimi dhe komunikimi mes folësve të krahinës.

Kështu, kur vjen një njeri në shtëpi të tjetrit dhe aty gjenë njerëz të tjerë, veç të shtëpisë, do të thotë: "*Qoft mer e merserrajni!*"; dhe të tjerët do ngrihen në këmbë dhe do t'ia kthejnë: "*O tu njaqeta, e merseedhe, hajde bujrum, merse të pru zoti, T'lumshin kamët!*". Pastaj ai takon njerëzit sipas moshës duke u dhënë dorën e duke u falë me ta sipas afërsisë.

Por zakoni e do që para se të hyjë brenda të thërrasë në oborr ose në "*shqym*" të derës me të madhe, sipas rastit: "*Oj shpaj, o i zoti i shpajs, o filani!*" (me emrin e të zotit të shtëpisë dhe të babait të tij).

Nga brenda dëgjon përgjigjen: "*Hajde bujrum, merse të ka pru zoti, merse erdhe!*".

Ai ia kthen: "*A dö miç! A je xhallë bre burrë! A ini ktu!*".

Tjetri ia pret: "*Miç e dashamer na ardhshin! Xhallë e tumer!*".

Në rast se në një grumbull burrash vjen një tjetër, atëherë ai thotë: "*Tunjatjeta e merse rrajni bre burra!*"; dhe për modesti u thotë mos lëvizni, por ata ia kthejnë: "*Merseedhe filani! Ou çar thu: mor burr, a jena xhit venit a si!*".

Përshëndetja karakteristike e zonës, si për të njohurit dhe për të panjohurit kur takohen në rrugë është: "*Si ia kalöni, si ja kalu:t*". Nëse janë punëtorë, që punojnë atëherë thuhet: "*Puna e ma:r u qöft!*", "*A u lödhët! Ju lumshin krahët!*". Edhe përgjigjja kthehet: O *t'mar paç e lum qöfsh!*" (kur është një përshëndetja bëhet në njëjës e kur janë dy ose më shumë bëhet në shumës). Në rastet kur burrat ndërrojnë duhanin thuhet: "*A po e nez nja he burrë!*"-: "*O tu rrajt nera e tu nez për t'mer!*".

Sipas kohës së ditës bëhen këto përshëndetje: "*Mermxhes, si u grete, a flete xha, mxhes, a mun u grete!*" dhe do të kthehet përgjigjja respektive për secilën: "*Mer si u grete taj, U gretëm ne söjt, Mer-mer ejvalla, copa-copa, çahu me copa, mer qöft beku zoti, si u grete taj, a flete, a mun u grete!*". Në çdo orë të ditës thuhet: "*Si ia kalöve, si ia çöve, si shkove!*".

Ndërsa kur ndeshesh me njerëz në rrugë, arë, krua, për dru, lumë në çdo kohë të ditës etj.,

thuhet: *"Shnet, shnet e t'mera t'mer laf, t'mer vof, drekën e mer, mermrama, natnemer t'mer e bash e xhum t'amël, t'mer e bash e t'mer flesh, a u lodhët, brava u qöft!"*.

Kur lind fëmijë matjani uron së pari jetë të gjatë: *"T'past le me jetë të gjatë, t'past le me jet' e nafa:k, ta lasht Zoti, me jet të gjatë, Zoti ta lasht e tu baft burrë!"*.

Çdo njeri që i pari e merr vesh lindjen e një fëmije, e sidomos djalë, prek një hekur që mund ta ketë afër, ose gratë prekin vathët e unazat, që lidhet me besimin se djali të rrojë e të bëhet i fortë si hekur e të plasë syri i keq. Kur takon në rrugë grua me fëmijë në krah thuhet: *"Marshalla e plast' seu i keç, Ta lash't Zoti, Ta rujt' Zoti, Past' fat e i prift' e mara!"*.

Njerëzit kur ndahen nga njëri-tjetri, të afërm ose jo, kur largohen nga shtëpia kemi përshëndetje të tilla: *"shnet, udha e ma:r, na ba t'fala, t'mer vofsh, t'mer ardhsh, t'prift shnedja, t'prift e mara, t'njefsha zanin e mer, t'najsha t'merën, t'prift fati e rruga e let!"*.

Për raste festash kemi urimet: *"Gzu festën, t'xhet ma mer sot ni vjet, ta hash shnosh me xhithë njerëzit e shpajs e me xhith ka të dasht', Ishalla ma plot sot ni vje:t, T'lumt gjëja e t'i rujt Zoti kalamajt e ta pruft Zoti mar, N'gzime u ardhshim përherë, Gzu e ishalla t'xhith bashk!"*. Nëse ka fëmijë në emigracion: *"T'ardhshin shnosh e t'i rujt Zoti, T'u prijë shneti e ishalla t'kenë marsi!"*.

Megjithatë, shkurtimisht vlen të përmendet se një ndër prirjet e sotme të të shprehurit të përshëndetjes në mbarë gjuhën shqipe (dhe në të folmen e Matit poaq), krahas efektit globalizues e huazues nga gjuhët e huaja, shkurtimit e tkurrjes së asaj ekzistuese, zëvendësimit dhe shmangies, shihet edhe një tendencë e re e brezit të të rinjve për të pakësuar dhe varfëruar modalitetet e pasura të shprehjes së përshëndetjes në gjuhën tonë, e ndikuar thellësisht nga teknologjia dhe zhvillimi i saj i vullshëm, që vuri para lëndën përshëndetëse, duke e kthyer në trajta të cinguar gjer në përçudnim. Pavarësisht nga bjerrjet dhe ndryshimet në pasojë të kushteve të reja të jetës, sidomos nga rrafshimi modernizues, që po merr përmasa gjithnjë e më të dukshme, përshëndetja ende ru-

het mirë nëpër të folmet dialektore si ujë i mirë që dallon nga uniformizimi gjithëpërfshirës i shoqërisë tonë.

(c) Rreth toponimisë së Matit në kuadrin e vlerave dialektore të saj

Qysh kur është krijuar gjuha njerëzore, vënia e emrit apo quajtja e njeriut si dhe emërtimi i sendeve, objekteve a dukurive që e rrethojnë atë, ka pasur rëndësi të madhe jetike, prandaj ka pasur kudo e kurdoherë një kodizim të quajtjes (përkatësisht të emërtimit), sipas një ndarjeje të madhe: emra të objekteve a dukurive të tilla që duhet t'i dijë çdo njeri apo makrotoponimet dhe emra të objekteve, dukurive të tilla që nuk janë të nevojshme t'i dijë çdo njeri, mikrotoponimet.

Materialet e botuara për toponiminë e Matit në tërësi janë të pakta, por studiues të huaj dhe shqiptarë kanë dhënë mendime të vlefshme gjuhësore për toponime të veçanta. Të dhënat arkeologjike të mbledhura në zona të ndryshme të Matit kanë dëshmuar se në vijimësi treva është banuar prej vendasve, që nga periudhat më të hershme ilire e deri sot, pandërpreje.

Toponimia e Matit përfaqëson gjithashtu, epoka dhe periudha të ndryshme historike. Ajo mund të shtresëzohet në toponime vendëse e të huaja, të vjetra dhe të reja, ilire dhe shqipe, latino-romane etj., ku pjesën më të madhe e zënë ato vendase dhe në numër më të pakët ato të burimit latino-roman.

Nga historianët pranohet se Mati është banuar prej fisit ilir të Pirustëve. Toponime si: *Qafa e Prushit, Brinja e Prushit*, që gjenden sot këtu, janë pranuar si dëshmi të një vijimësie iliro-shqiptare edhe gjuhësisht nga Çabej. Toponimi *Mat, Matja*, dhe formimet e tjera prej tij *Lumi i Mates/Matit, Breg Mati, Breg Matja* hyjnë në listën e emrave të vjetër antikë.

Mati apo Matja? Lumi e mori emrin nga krahina apo krahina e mori nga lumi, si dhe origjina e toponimit, kanë qenë dy aspekte me të cilat janë marrë shumë studiues, pa arritur në një përfundim të mirëpranuar nga të gjithë. Sipas etimologjisë popullore thuhet se nga krahina e mori emrin edhe lumi që njihet si '*Lumi i Matit*', por ky shpjegim nuk qëndron sipas një pjese të mirë të

studiuësve që thonë se është lumi ai që i dha emrin krahinës.

Në dokumentet e shkruara emri Mat del herët. Por, nga të gjithë pranohet që ky është emër autokton dhe që duhet të ketë lidhje burimore me vendin dhe me gjuhën që kanë folur banorët e hershëm të tij, në kohën kur iu është dashur të emërtojnë lumin dhe krahinën, i kanë përdorur paralelisht. Nëse është e para krahina apo lumi i pari, kjo sot duket aq e zakonshme në gojën dhe mendësinë e banorëve, sepse të dyja përfaqësojnë një të tërë: krahinën e Matit.

Toponimi i fshatit *Laç* hyn në emrat gjeografikë të vjetër, që del dhe si antroponim në Mat dhe në krahina të tjera të vendit. Duket të ketë ardhur nga forma *Latium-Latio* dhe në formën e sotme del që në dokumentet turke (1467).

Toponimet *Shkopet* dhe *Lis* në Mat, gjithashtu dëshmojnë që herët (shek. VI).

Emërtimi *Benë* dhe formimet: *Mali i Benës*, *Përroi i Benës*, *Rrënza e Benës*, *Fushë-Benë*, *Çabej* e lidh nga greqishtja me *bëndë*, me kuptimin anë. Te Budi del *Benda*.

Toponimin *Rrënza (Rranxa)* që shënon një krahinë nga Kurbini në Gur të Bardhë e lidhin ose me latinishten *radix* (Majeri), ose e burimit të vjetër vendas (Çabej).

Mali i Dejës, që del më 1198, një tjetër toponim i vjetër, sipas Çabejt do të thotë *vend ku shkrin bora*.

Emri i fshatit *Dukagjin*, del që -1402, i lidhur me emrin e një familje fisnike arbëreshe. Me të lidhen ngjarje të mëpastajme historike në Mesjetë, *Kuvedi i Dukagjinit*.

Emërtime të periudhës latino-romane janë provuar se gjenden në toponiminë e Matit nga gjuhëtarë tanët: *Dom* > dominus / vend, kodër; *Vinjall* > vinealis, terra / vendvreshtash; *Fulqet* > fil(i)cetum / lulearre; *Vila* > villa / shtëpi, katund; *Val* > vallis / luginë (fshati *Val*, *Gryka e Valit*, *Maja e Valit*, *Fushat e Valit*, *Qafa e Valit*, *stanet e Valit*, toponime në Vig, Vinjall, të Matit); *Shutrrreja / Shutrrija* toponim në Bruç, vjen nga një *subterraneum* e lat. / e nëndheshme, prej saj vijnë: *Përroi i Shutrrrejës*, *Shpella e Shutrrrejës*, *Shutrrija e Valit*, *Shutrrija e Ballet*, *Shutrrijas (t)*.

Toponimet e lidhura me terminologjinë kish-tare romake, me *shën(m)* dhe *kishë*, që hasen në Mat janë shpjeguar prej gjuhëtarëve si vijuese dhe dëshmuar të fazave të hershme. Përmendim: *Shtjefën*, *Shëlli*, *Gjon*, *Shëndou*, *Shëngjun (fshatra)*, *Shënkoll (kishë)*, *Qafa e Shënkollit*, *Shëndthimi*, *Shëtrinë*, *Kisha e Shënepremtes*, *Ura e Shënepremtes*, *Shëmria*, *Kroi i Kishës*, *Livadhi i Kishës*, *Porta e Kishës*, *Kishat*, *Kroi i Prifit*, *Gryka e Kishës*, *Kisha e Madhe*.

Gjatë shqyrtimit të toponimeve të mbledhura në këtë zonë kemi vënë re se ato janë formuar duke mbajtur parasysh dy aspekte bazë të apelativit: aspektin kuptimor dhe aspektin ndërtimor.

Kryesisht në toponiminë e kësaj zone mbizotërojnë emërtimet e përbëra, gjë që shpjegohet me faktin që togfjalëshi toponimik jep mundësi më të mëdha, sidomos për makrotoponimet. Të përdorur janë dhe toponimet me bazë antonimie ose me mbiemra të nyjshëm si: *i bardhë*, *i zi*, *i madh*, *i vogël*, *i gjatë*, *i shkurtër*, *i ri*, *i vjetër*, *i kuq etj.*

Emërtime të thjeshta: *Gur*, *Shkallë*, *Cërujë*, *Miza*, *Gurrë*, *Frankth*, *Batërr*, *Bushkash*, *Fushas*, *Kodrat*, *Shullani*, *Ndejulëza*, *Lushtat*, *Milore etj.*

Emërtime të përbëra: *Kodra e Shullanit*, *Qafa e Lëgatës*, *Përroi i Lëgatës*, *Ara Mesvil*, *Maja e Borës*, *Qafa e Thanës*, *Kodra e Linit*, *Ara e Gjatë*, *Boka e Kuqe*; *Maja e Dejës*, *Maja e Dërvajshës*, *Shpella e Lurthit*, *Sheshi i Dheut*, *Qafa e Shtrugës*, *Fusha e Ushtazës*, *Mali i Butrrojës*, *Shtegu i Lopve etj.*

Emërtime vendesh me emra njerëzish: *Sharrat e Patushit*, *Ara e Sulkurtajve*, *Përroi i Sinanajve*, *Kroi i Gjokës*, *Ceta e Bashe*, *Rrasa e Palamanit*, *Kroi i Hasesës*, *Kuçlenat e Doçajve*; *Shpella e Kolgjegjës*, *Kisha*, *Stalla*, *Mulliri i vjetër*, *Ura e hekurit*, *Ura e keqe*, *Kroi i ri*, *Vorri i mirë*, *Teqja e Prellit*, *Stallet e Xhakrose etj.* Toponime me elemente të tilla: *Të poshtra*, *të epërme*, *nën ose mbi*, *mbas*: *Mbaskunjes*, *Ndërfushas*, *Ndërbalë*, *Ndërkrua*, *Lera e Poshtë*, *Lera e Epër*, *Liqeni Mbasdeje*, *Nënudha*, *M'rrasas*, *M' krua etj.* Ka megjithatë toponime të thjeshta të shpërndara në gjithë Matin, të cilave ende nuk u jepet shpjegim: *Baz*, *Xibër*, *Ketë*, *Dars*, *Patin*,

Bruç, Dërjan, Macukull, Zenisht, Splaj, Kalqyra, Guja, Qebas, Plana, Balgjaj, Jesull, Fagu, Mjedha, Flimi, Pletar, Bacitul, Kmarsh, Nevestër, Benë etj. ashtu si ka toponime të tilla të përbëra po pa shpjegim: *Qafa e Palteres, Fusha e Pebithit, Kodra e Termeshinit, Maja e Fangut, Përroi i Flimit, Kodra e Kabolit, Kodra e Përmarsit* etj.

Disa toponime të përngjitura, si: *Tejdeja, Kryematja, Përteujë, Tejlum, Gjelzat, Brinemat, Ndejulëza, Mbaskunjes, Pjesnaja, Sipraja, Rrethatur, Çuprrrela, Elbare, Xixulla, Pribelet, Pjejëza* janë shumë interesante për nga mënyra e formimit, e hasur si mënyrë emërtimi në onomastikën shqiptare.

Ndër mjetet fjalëformuese të vjetra për krijimin e toponimeve mund të përmendim, parashitesat, prapashtesat, kompozimin, përngjitjen: *-at, -esh, -et, -ot, -i, -in, -ull, -ush, -th/z* etj. *Ujat, Fshat, Murgat, Rrëbat; Madhesh, Bulçesh, Bushnesh, Zgërdhesh; Shkopet, Burgajet, Maja e Bladzet; Dërja, Gërman, Bijan, Kijan; Barjot, Kastriot; Shëlli, Bërshi, Valgji; Patin, Kukatin; Rremull, Macukull; Lapushë, Vjetrushë; Melth, Malthi, Përroi i Gurthit, Gurrëzit, Përroi i Gurrës, Firzet, Grykëzirt, Gurëza, Fusha e Pebithit, Përroi i Pebithit, Sheshëzat* etj.

Përfundime

Toponima e Matit e trajtuar kësaj si një pjesë përbërëse e makrostrukturës së përgjithshme të toponimisë shqiptare, është një vijimësi e saj në kuptimin që ajo qoftë në aspektin semantik, në atë strukturor (morfologjik e fjalëformues) dëshmon përbashkësi dhe njëllojshmëri. Edhe në mënyrën e emërtimit, me bazë lëndore, konfigurative, ngjyre, materiali, përkatësie, emra njerëzish, kafshësh, pozicioni gjeografik etj. tregon se është në një hulli me

emërtesat e vendeve në mbarë shqipen. Gjithashtu edhe elementet gjuhësore, që ndihmojnë në përfitim të tyre janë po aq të ngjashme a të njëjta në model me mjetet fjalëformuese dhe strukturën morfologjike të gjithëtoponimisë shqiptare, sa që nuk lë shteg për shmangie nga ky model.

Qoftë në strukturë apo dhe në semantikë, toponimia e Matit mbetet pjesë e së tërës. Sepse në të parën përdoren ato rrugë, mjete e forma për krijimin, shpjegimin dhe zbrërthimin e tyre; ndërsa në të dytën kjo toponimi dëshmon po aq hershmëri dhe vijimësi të elementit të moçëm apo edhe në mënyrën se si kanë ndjerë shqiptarët nevojën për të emërtuar vendet e rreth e qark vetes.

Uniteti kulturor dhe toponomastik i kësaj krahine me trevat e tjera të Shqipërisë, flet si për lidhje të vjetra të Matit me trojet mbarëshqiptare, ashtu dhe për vijimësi të pandërprerë banimi në këto troje të një popullsie iliro-shqiptare me një nivel kulturor e qytetërim të zhvilluar

Bibliografia

- BECI, B. (1962/2, 1963/3), Hulumtime gjuhësore në Mat: BUSH, SSHSH, 1962/2, 1963/3.
 HAS'HYSAJ, M. (2011), *Vështrim dialektologjik dhe socio-etnolinguitik në të folmen e Përtejës (Mat)*, (Mikrotezë për gradën "Master"), Tiranë.
 SHKURTAJ, Gj. (2000), *Sociolinguitika*, SHBLU, Tiranë .
 SHKURTAJ, Gj. (2001), *Onomastikë dhe etnolinguitikë*, SHBLU, Tiranë.
 SHKURTAJ, Gj. (2009), *Sociolinguitikë e shqipes – Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, Tiranë.
 STUDIME Filologjike, 1982, 1983, 1984..

ALBANIAN ROLE IN CHINA'S UN ADMISSION

ROLI I SHQIPERISE NE PRANIMIN E KINES NE OKB

BLERTA DERHEMI (BITRI)
Ministry of Foreign Affairs, Tiranë, ALBANIA
blertaderhemi@yahoo.com

AKTET VII, 3: 238 - 240, 2014

PERMBLEDHJE

Të flasësh rolin e Shqipërisë në pranimin e Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, organizatë me rëndësi për gjithë dekadat pas Luftës së Dytë Botërore, tingëllon disi paradoksale. Paradoks për diferencën e përmasave gjeografike dhe demografike të dy shteteve, por dhe për peshën që ato kanë si aktorë ndërkombëtarë. Pikëpyetja ngrihet rreth rolit të Shqipërisë në këtë anëtarësim, i cili mund të përmbliidhet në përgjigjen e pyetjes: Cila ishte situata e vërtetë ndërkombëtare e kësaj periudhe dhe a ishte vërtet lufta e diplomacisë shqiptare që siguroi vendin e Republikës Popullore Kineze në OKB? Kina u pranua në OKB në vitin 1971 pas votimit të rezolutës së paraqitur nga Shqipëria. Ndërsa Shqipëria arriti përmbushjen e qëllimit të saj diplomatik. Ky moment shënon një nga arritjet më të mëdha të diplomacisë shqiptare në atë kohë. Punimi do të jetë i bazuar kryesisht në dokumentat arkivore, artikuj dhe punime të autorëve të mëparshëm.

Fjalët çelës: OKB, Rol, Rezolutë, Pranim, Diplomaci

SUMMARY

Talking about Albania's role in China's accession to the United Nations Organization, an organization inalienable importance for all decades after World War II, sounds somewhat paradoxical. The paradox lies not only on the difference of geographic and demographic dimensions of the two countries but the weight and importance they have as actors of the international arena. The questions about Albania's role in this membership are: What was the real international situation of that period? Was it really the albanian diplomatic efforts that secured the Chinese People's Republic's place at UNO, or was Albania used by other powers to grant this place to China? China was admitted to the UN in 1971 after the resolution submitted by Albania was voted. Albania fulfilled its diplomatic goal, this moment marks one of the greatest achievements of its diplomacy of the time. Paper will be based primarily on the archived documents, articles etc.

Key words: UNO, Role, Resolution, Admission, Diplomacy

To talk about Albania's role in China's accession to the United Nations Organization, one of the most important organization for all the decades after World War II, sounds somewhat paradoxical. The paradox lies not only on the difference of geographic and demographic dimensions of the two countries but on the weight and importance they have as actors of the international arena.

Albania was one of the first countries to recognize the People's Republic of China after the Communist Revolution of 23 November 1949. Immediately after the revolution the PR China demanded the expulsion from the United Nations of Chan Kai Shi representatives and considered themselves as the only legitimate representative of China. Foreign policy of PR China in its infancy was oriented and solidarized with the USSR and other communist countries. Pursuing this political

line also had its impact on Albania, which also followed the same politic ideology for years and had very close relations with the USSR.

Both those countries, Albania and China, for a relatively long period shared the same fate of being outside the largest international organization after the Second World War, of course for quite different circumstances and reasons. Even the relations of two countries with the UN was quite different. People's Republic of China was a founding member of the United Nations, since their creation in 1945 and as well as a permanent member of the Security Council. Diplomatic relations between big China and Albania were established in 1955, the year which coincides with the year of addmition of Albania to the United Nations. Enver Hoxha's and other high communist leaders visited China in the mid 50'. This visit open the way of a long cooperation, that would culminate in the 60'-70'. If for Albania, the UN was the only place where it could unfold its multilateral diplomacy, for China, restoration of its rights, had a special importance for it to enjoy the prestige and privileges of being a superpower. Yet, the little Albania was used quite well not only from China, but also from other two superpowers, USSR and USA, to achieve this goal, while with the latest (USA) either China nor Albania had yet not established diplomatic relations.

The early 60s coincided with the end of good diplomatic relations between Albania and the USSR, which pushed Albania's approach to China further. This approach not only was because of ideological conformity, communism, that they had in both countries, but also for the numerous benefits in economic and technical benefits that Albania would take from the developed China of the time. In the analysis of the 1962 for the achievements of Albania in Foreign Trade, is said: " Fraternal assistance and cooperation between our countries and other socialist countries, based on the immortal principles of Marxism-Leninism and proletar internationalism, has found a clear expression in the relationships between our countries and the People's Republic of China. Trade relations with PR China had an important

place for Albania. RP China today's grants to our countries an invaluable internationalist help, either through long-term loans for new works for the third (five-years plans), or in providing the needed goods for our economy through mutual exchanges" (Archive of Albanian Ministry of Foreign Affairs, file 25, page 8).

Another factor that indicate Albania to gave support for the most adamantly demanding of the restoration of the rights of China to the UN, was the new geopolitical reconfiguration of the world in the late 60s. It was the period of the creation of many new states as a result of decolonization which increased the number of new member states of the UN, that were in favor of the Chinese case. Exept these countries, were added the Eastern European countries that had already left behind the squabbling between USSR and China, and were openly supporting China.

Besides the above, special and crucial role for China's admission to the UN had the U.S. itself, which for nearly 30 years recognized as the legitimate representative the Republic of China (ie not the People's Republic of China), or known otherwise the governement of Taiwan. Through those years, the confrontations of those two countries in the Korean and Vietnam wars, seemed to have caused irreparable cracks in the diplomatic relations between them. The U.S efforts were not in the directions of preventing China addmition in the UN, but also to convince its allies to don't cooperate with it. In cooperation with its allies, the U.S imposed a trade embargo on China in Order to damage its economy. This hostility of the U.S. toward China, pushed even further Albania's support for China, because Tirana's politics of the time viewed with suspicion and distrust every step taken by Washington.

Starting from the fourth session of the United Nations until 1962, China's demand for admission to the UN was made by USSR, having the support of other communist countries including Albania. These requests were repeatedly rejected by the U.S. and countries supporting it, making it impossible to put this issue on the agenda of the annual meetings of the Assembly. The year 1962

marks an approach of the USA to the USSR, with which Albania halted any relation in late 1961, attaching itself to China. This situation is evident in the announcement that the Albanian Mission to the UN sends to the MFA:

“The XVII session of the General Assembly began its work in time when relations between the U.S. and the Soviet government were, due to the treason politic of the Soviet leadership, relatively warmer than in the XVI session, which was assembled at a time when the international atmosphere was raging because of the aggressive reaction of the imperialists to the Soviet proposals for the German problem and West Berlin, and in relation to the restarting of the trials experiments by the USSR (Archive of Albanian Ministry of Foreign Affairs, file 662/22, page 9).

At the first glance, the main feature of the works of the XVII session, and what caused attention in the previous session was the spirit of reconciliation between the imperialist bloc headed by the US, and the group of the socialist countries headed by the USSR.

On the other hand, the following period was accompanied by a series of meetings of Chinese diplomats in Tirana with the highest representatives of the Albanian Foreign Ministry, to give them instructions regarding their attitude they should hold at the UN General Assembly meetings. In those meetings, was spoken even about the efforts made by the USSR for using China's cause in preventing the solving of the Asian African issue for fairer representation in the key UN bodies.

After the deterioration and the roughening of the Soviet-Chinese relations in 1963, the initiative for the admission of China to the UN was taken by Albanian Diplomatic Mission at the UN, in New York. Co-presenting the Albanian resolution was Cambodia. Starting from the 1964 until the 24th session of the UN, the initiative was taken by Cambodia, meanwhile Albania, alongside some other states from Asia and Africa were co-presentators.

But the role of Albania in this admission seems to not have been decisive, since PR China itself had started to adjust its relations with the USA, which was the main obstacle, and the reformulation of the American attitude toward communist China, which was seen now, among other things, as a powerful economical partner. In this approach between two Super Powers, the main role belongs to Pakistan, which accepted to play the role of the “secret diplomatic channel”. It was through it (Pakistan) that the first secret visit of Kissinger in China took place, and was followed by another visit in 1971, while the UN General Assembly was discussing exactly the admission of China in the UN. Nixon and Kissinger believed that they could further improve the relations with the USSR by opening with China. While China itself believed that the USSR was a greater danger to them than the USA, in which case the geographic distance constituted a favor. In those conditions, Albania was used as a good player from Great Powers, in so many sessions of General Assembly of United Nations Organisation.

Bibliography

- ARCHIBUGI, D. (1993), The Reform of the UN and Cosmopolitan Democracy: A critical Review: *Journal of Peace Research*, Vol. 30, No. 3. (August): 301-315.
- BLUM, Y. (2005), Proposals for UN Security Council Reforms: *The American Journal of International Law*, Vol. 99, No. 3. (Jul): 632-649.
- BERTRAND, M. (.), The Historical Developments of Efforts to Reform the UN: A. Roberts, B. Kingsbury (ed.), *United Nations, Divided World* (USA: Oxford University Press): 430-431.
- MELTZER, R. (1978), Restructuring the UN system: Institutional Reform Efforts in the Context of North-South Relations: *International Organization*, Vol. 32, No. 4. (Autumn): 993-1018.
- RUSSETT, B. (1996), Ten Balances for Weighing UN Reform Proposals: *Political Science Quarterly*, Vol. 111, No. 2. (Summer): 259-269...

VËSHTRIM STILISTIKOR MBI ROMANIN E ISMAIL KADARESË *KRONIKË NË GUR*

STYLISTIC OVERVIEW OF THE ISMAIL KADARE NOVEL *CHRONICLE IN STONE*

SASHENKA KAMBERI

Universiteti i Gjirokastrës

Email: sashakamberi@yahoo.com

AKTET VII, 3: 241-245, 2014

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim ne synojmë ta përqendrojmë punën tonë në analizën e gjuhës së përdorur prej Kadaresë, në romanin *Kronikë në gur*, duke listuar disa prej tipareve kryesore që kanë shkallë të lartë shprehësie në këtë vepër. Nisur nga hapësirat që na lejon një punim i tillë rritet shkalla e vështirësisë për të bërë një analizë shteruese në të gjitha rrafshet gjuhësore, prandaj do të përqendrohemi kryesisht në përftesat leksikore e semantike që realizon autori. Shprehësia semantike që vjen nga zgjerimi kuptimor i njëjve leksikore, afria e pazakontë e fjalëve apo lidhjet e rralla mes tyre, të cilat janë burim për krijimin e tropeve gjuhësore origjinale të Kadaresë, do të jenë objekt i punës sonë. Në fund të punimit do të evidentojmë disa prej këtyre tipareve stilformuese që ndikojnë në krijimin e stilit origjinal të autorit.

Fjalë çelës: shprehësi, shtresë leksikore, përftesë semantike, stilformues

SUMMARY

In this paper we intend to concentrate our work on the analysis of the language used by Kadare, in the novel *Chronicle in Stone* listing some of the key features that have a high degree of expression. Given the space that allows us to work, such a degree of difficulty to make an exhaustive analysis at all levels of language rises, so we will concentrate mainly on the lexical and semantic procedures the author realizes. A great interest arises mainly the harmonization of different lexical liars enabled and its functions at work. Expressive semantic expansion coming from the lexical semantic units, unusual affinity of words or rare links between them, which are the source for the creation of stylistic figures the author creates, will be the objective of our work. In the end of this work we will identify some of the features that affect the creation of the author's style.

Key words: expression, lexical liar, semantic procedure, style formation.

Hyrja

Ismail Kadare është shkrimtari që shquhet sot, në letrat shqipe për thesarin e çmuar që i lë letërsisë dhe gjuhës sonë. Vlerësimet për veprat e tij kanë qenë të shumta dhe të pashtershme, të frymëzuara nga befasia që shkakton tematika e zgjedhur, optika origjinale e perceptimit dhe trajtimi interesant i ngjarjeve në dukje të zakonata, por sidomos nga përpunimi mjeshtëror dhe latimi i kujdesshëm i fjalës shqipe. *Kronikë në gur* është

ndër romanet e parë të Ismail Kadaresë, por që ndikoi fuqishëm në identifikimin e personalitetit krijues të autorit. Ai sot është një roman i përbotshëm, i cili magjeps lexues të kudondodhur. Gjithashtu ai është një roman, i cili përfaqëson autorin në antologji të ndryshme letrare, dhe tekste mësimore, prandaj kjo vepër nxit përfytyrimin, por dhe interesin për perceptime të hollësishe. Pikërisht për këtë, ne zgjodhëm të depërtojmë në disa nga vlerat dhe tiparet stilformuese të mozaikut shumëvlerësh që

prezantohen në të. Për shkak të prurjeve të shumta, klasifikimi shterues i të gjithë elementëve stilistikor[do t'i kalonte kërkesat e një punimi të tillë, ndaj menduam të përmendim disa prej përbërësve më tipikë stilistik si: tipare të ligjërimin, shprehësinë semantike e leksikore, të cilat dukshëm evidentojnë stilin e veprës.

Si në gjithë shkrimtarinë e tij edhe në romanin *Kronikë në gur* Kadare përdor shqipen standarde, *çka do të thotë se u përmbahet po atyre normave drejtshkrimore dhe gramatikore të shqipes së sotme, njësoj si pjesa dërrmuese e krijuesve shqiptarë, porse kjo nuk e pengon atë aspak për të shprehur vetjakësinë dhe veçantitë e tij gjuhësore.* Ai përdor me mjeshtëri mundësitë shprehëse të shqipes së njësuar, por befason dhe me krijimin e vlerave origjinale.

Ligjërim me fraza të copëzuara

Autori e vendos rrëfimin në gojën e rrëfimitarit-fëmijë, i cili ende nuk ka një përfytyrim të qartë për botën, për qytetin dhe hapësirat rrethuese të tij, për njerëzit dhe bisedat e tyre të gjata, aq më pak kompetencën gjuhësore për të kuptuar gjithçka thuhet. Duke harmonizuar naivitetin e rrëfimitarit me racionalitetin e të rriturve krijon shprehësi e ligjërim të pasur me shtresëzime të ndryshme. Ligjërimi i Kadaresë është në përgjithësi një ligjërim i përzier, i përbërë nga ligjërimi monologjik (i autorit) dhe ligjërimi dialogjik (ose i personazheve). Shtresëzimi i regjistrave gjuhësor e ka burimin pikërisht te këto ligjërimë. Ligjërimi monologjik zë hapësirën kryesore në vepër. Rrëfimtari bën përshkrime të hollësishme të situatave dhe njerëzve përçark tij. Ai analizon hollësishëm gjithçka që i ngacmon kureshtjen, duke përdorur një gjuhë të pasur me figuracion, me mjete të përzgjedhura leksikore dhe larmi frazash. Ja një nga shembujt e shumtë, ku rrëfimtari analizon a aludon për ekzistencën e gjërave: *Po mendoja se si ka qëlluar që njerëzve u ka rënë në mendje të grumbullojnë kaq shumë gurë e drurë, të bëjnë me to gjithëfarë muresh dhe shtëpish, dhe pastaj këtij grumbulli të madh rru-*

gësh, strehësh, tymtarësh e oborrresh t'i vënë emrin qytet.

Gjendja e tij emocionale ndryshon në varësi të gjërave që ndodhin në qytet dhe kjo ndihet në frazat që ai përdor. Gjendjen e trazuar të personazhit-rrëfimtari ose të qytetit, shkrimtari e shfaqëron me një tip fraze të copëtuar, duke shndërruar gjymtyrët e fjalisë në fraza të veçanta mungesore. *Gjumi, s'po më zinte. Libri ishte aty pranë. I heshtur. Mbi nim. Diçka e hollë. Fare e hollë. E habitshme. Brenda dy mbulesave prej kartoni rrinin zhurma, porta, ulurima, kuaj, njerëz. Pranë e pranë. Të shtypur me njëri-tjetrin. Të zbërthyer nëpër shenja të vogla, të zeza* (Kadare 1972: 77).

Ligjërim me fraza eliptike

Përsheptimi i ritmit që rrjedh nga ngarkesa emocionale dhe gjendja halucinate e rrëfimitarit, realizohet me fraza eliptike. Ky tip frazash është më i shpeshtë në faqet e kronikës, ku ngjarjet dhe lajmet prezantohen pa komente dhe analiza. Ato renditen njëra pas tjetrës me lakonizëm.

Në vepër dallojmë herë pas here dialogë të krijuar nga zëra të painedifikueshëm. Gjuha në këto raste është e mbushur me proverba, frazat janë të shkurtra në formën e sentencave. Aty mungon fjala e rrëfimitarit për të bërë shpjegime. Ndërsa psikologjinë e qytetit autori zgjedh ta zbulojë nëpërmjet dialogëve të grave. Ato flasin për gjëra të zakonshme, por alarmohen sa herë ndodhin gjëra që trazojnë përditshmërinë.

Në ligjërimin e tyre bisedor ka replika të shumta e intensive, mbushur me pasthirma, mall kime, proverba, ndonjëherë dhe me orientalizma. Konteksti të ndihmon të kuptosh fjalitë e shpesh mungesore që ato përdorin. *P.sh. E morët vesh, moj korba. Nuses së Babametos i shteroi qumështi! –U, luaj vendit, -tha nëna dhe u zverdh. –Ç'u bë atje moj gra, ç'u bë atje! Kërko magjinë në trenj e kërko në qilare. Kthe shtretër e përmbys arka. E bënë shtëpinë lesh e li gjersa e gjetën.* (Kadare 1972: 44). Autori vendos gjuhën e gjallë në funksion të personazheve dhe situatave, por kujdeset për të mos rënë në banalizmin që provokojnë këto tipa dialogësh.

Ligjërimi enumerativ

Fraza kadareane të jep mundësinë të lundrosh në një det përftesash. Ajo nuk ka tepri të pancevojshme, sikurse nuk ka as mungesa të pamotivueshme. Për vetë natyrën e rrëfimit në roman dominojnë kryesisht frazat e shkurtra dhe mesatare, por jo vetëm. Më të njëjtën mjeshtëri autori ndërton herë pas here fjali të gjata të përbëra e të mbipërbëra, megjithatë edhe ato karakterizohen nga intensiteti dhe ritmi i përsheptuar. Fjali të tilla autori përdor më tepër kur transmeton kaosin, frikën, pasigurinë që kap qytetin sa herë ka pushtime, kapitullime a ndërtrim qeverisjes. Në faqet e fundit të romanit hasim një frazë të gjatë, por të thjeshtë, plot epitete përafres mes njeriut dhe gurit, në të cilin njerëzit shkruajnë kronikën e jetës së tyre në një qytet të ndërtuar prej guri. *Kemi ardhur nga ai qytet atje. Njohim gurët. Ata janë si njerëzit: të ashpër, të butë, të kuqerremtë, me pore, të rinj, pleq, të lëmuar, me rrudha, me damarë, qoshemprehtë, dinakë, bablokë, që të mbajnë këmbën kur rrëshqet; të pabesë, që shqyhen gazit me fatkeqësinë tënde; të besës, gati të rrijnë me shekuj nëpër themele, si në detyë; marrokë, të vrenjtur, krenarë, që ëndërrojnë të bëhen pllaka përkujtimore; të thjeshtë, që shërbejnë pa shpërblim, shtruar udhëve në rreshta të pafundme si populli, pa emra, pa emra, pa emra, në jetë të jetëve.* (Kadare 1972: 293).

Në këtë fjali, por dhe në shumë të tjera të bie në sy përdorimi i *enumeracionit*, renditja e njëpasnjëshme e fjalëve të së njëjtës kategori gramatikore, të cilat bashkë me vlerat sintaksore, leksiko-semantike e stilistike, ndikojnë dhe në ritmin dhe muzikalitetin e frazës, duke e bërë atë më poetike.

Enumeracioni a numërimi është tipar stilformues në romanin *Kronikë në gur*, për shkak të dendurisë së përdorimit dhe shumëllojshmërisë së ndërtimit. Emrat, mbiemrat dhe foljet krijojnë vargje kryesisht me tri, por dhe më tepër gjymtyrë të renditura.

Ja disa shembuj: *Nata dimërore kishte mbështjellë çdo gjë me ujra, mjegull, erë.* (Kadare

1972: 15); *Si nuk pëlciste njeri nga gjithë kjo masë e madhe drite, hapësire dhe ngjyrash që derdheshin e derdheshin pa pushim mbi të.* (Kadare 1972: 28); *Ndërsa njerëzit bërtisnin, ulërinin, shanin, era e lehtë e jugut e shtrajtoi tymin në dytri vende.* (Kadare 1972: 229) etj.

Enumeracioni te Kadare shfaqet me denduri dhe variacion. Mes vargjeve të krijuara nga radhitja e njësisve leksikore vërehet shpesh lidhja semantike mes tyre, duke shkuar drejt shkallëzimit, i cili realizohet me *anën e vargut të hollësive dhe imtësive të radhitura sipas një hierarkie kuptimore*. Kështu fjalët e pranëvendosura janë të afërta nga kuptimi, por të ndryshme për nga nuanca dhe ngjyrimet stilistike. P.sh. *Një tundje, një trazirë, një rrokullimë, çdo gjë përmysej e vinte rrotull sikur i frynte qoftëlargu.* (Kadare 1972: 26). *Qyteti i shkaktonte asaj padashur shumë dhembje, gërvishtje dhe plagë* (Kadare 1972: 14); *Ishte një gjumë i mundimshëm, i ndërprerë e i shqyer nga gropat e rrugës.* (Kadare 1972: 281); *Zinxirët duke u fërkuar me gurët rënkonin, ulërinin, lëshonin xixa.* (Kadare 1972: 299). Ato janë atje, *të përjetshme, të ngrira në gur, bashkë me shenjat që kanë lënë sipër tyre tërmetet, dimrat apo rrebeshet njerëzore.* (Kadare 1972: 306).

Në këto raste karakteristikë është pranëvendosja e njësisve, të cilat shkaktojnë zgjerimin e segmentit të thënies dhe mundësitë e saj shprehëse. Duke patur këtë natyrë shkallëzimi shprehja bëhet më e pasur jo vetëm me njësi leksikore, por me hijëzime semantike e stilistike. Kështu *përmbajtja zgjerohet, sepse fjala e re sjell ngjyrime kuptimore, emocionuese stilistike etj.*

Shpesh nga ky shkallëzim tiparesh, dukurish a veprimesh krijohen çifte a vargje sinonimike, nga të cilat mbizotërojnë ato kontekstuale. Shembujt janë aq të shumtë e të ndryshëm nga njëri-tjetri, sa ngacmojnë për hulumtime më të hollësishme, megjithatë përmendim disa ku konteksti letrar lejon afrimin e fjalëve jo sinonime të mirëfillta: *deri sa nëna ime t'i nxirrte me vedër, të hutuara dhe të shushatura* (Kadare 1972: 16); *Kohë të këqija, kohë të turbullta, ah moj xhiko është kohë e pabesë kjo* (Kadare 1972: 18); *Mirëpo, në një natë*

fortune, ato ngjalleshin, fryheshin, vërshëllenin, cijasnin, ulurin (Kadare 1972: 21); Në këtë lagje ishin të bukura dhe të pangjashme sidoms mbrëmjet (Kadare 1972: 62); një mizëri e pafundme shkronjash arabe, që prisnin të më merrnin me vete dhe të më shpinin në **fshehtësi** dhe në **mistere**. (Kadare 1972: 63); *Kati i tretë ishte i lehtë, gati i mosqenë. Ai ishte ëndrra e qytetit, trilli i tij, fluturimi i fantazisë së tij.* (Kadare 1972: 114).

Përftesa me sinonimet kështu ka natyrën e shkallëzimit të tiparit ose kërkon ta vërë në dukje atë tipar. Merita e autorit qëndron në renditjen e fjalëve, të cilat konteksti i ndihmon të gjejnë përbërës të njëjtë semantikë. Me kohë, disa prej tyre mund t'i zgjerojnë mundësitë e zëvendësimit të njëra-tjetrës, duke u kthyer në sinonime leksikore të zakonshme.

Përshtypje në roman bën afrimi i pazakontë i fjalëve nëpërmjet krahasimit. Me lehtësinë që zgjeron vargun e sinonimeve, autori pranëvë a krahason dukuri, sende e cilësi të ndryshme. Krahasimet e përdorura në roman shquhen për fantazi përqsasje, shkallë të lartë figurshmërie e vlera të larta stilistikore. Kjo është një pasuri e çmuar që i lë ligjërimin artistik të shqipes. *Fjalë me kuptime të rrëshqitshme si ujit.* (Kadare 1972: 20); *koka të tjera vinin vërdallë, sytë plasnin si fishkë, disave u ngrinte gjaku si akullore... Një pus drite u zgjat befaz përpara si një rrëshqanor i tejudkshëm.* (Kadare 1972: 97); *Fishkëllimat si pyka të mëdha po i nguleshin pa mëshirë tokës.* (Kadare 1972: 128). Këtu fjalët e tyre filluan papritur të veshtulloheshin e të fryheshin si brumë etj.

Efekt krijojnë dhe lidhjet jo të zakonshme të fjalëve duke shfrytëzuar një lloj analogjie të pashprehur: *Midis dy kujave një luginë heshtjeje. E thellë. Pastaj prapë malet e kujës. Të larta, valë-valë. Gropë heshtjeje. Kujë. Kujë si një lëvozhgë ajo mbështjellë një fishkëllimë që përpiqet ta shpojë.* (Kadare 1972: 118). *Kisha vënë re se retë vdisnin shumë shpejt. Kufomat e tyre ende-shin për një kohë të gjatë nëpër qiell.* (Kadare 1972: 225). *Copëra kujtimesh, gjysma frazash ap*

fjalësh; bishta ngjarjesh të parëndësishme, ndërprisnin njëra-tjetrën (Kadare 1972: 63).

Metafora dhe metonimi magjepsëse

Gjuha e përdor në roman dëshmon për një njohje të thellë të strukturave kuptimore nga ana e autorit, i cili krijon një figuracion magjepsës duke shrytëzuar mundësitë e fjalëve për të fituar kuptim të figurshëm a duke krijuar kuptime të reja. Në këtë qytet të çuditshëm, që në sytë e fëmijës ka tipare njerëzore shumëçka është shrytëzuar e nga kjo kanë marrë jetë një varg metaforash e metonimish. Në pamundësi për të sjellë shembuj të zgjeruar, po përqëndrohemi vetëm në figurat që vijnë nga animizimi i qytetit.

Vetë titulli *Kronikë në gur* është metonimi, ku guri përfaqëson qytetin dhe qyteti banorët. Animizimi i qytetit duket që në faqet e para, duke u shfaqur si *qenie prehistorike* a si *kafshë kacavjerrëse*. Ai ndjen pulsën e jetës që gjëllon brenda tij dhe njehësohet me banorët. Ai herë është dashamirës e herë zemërohet, herë hakmerrret e herë është mospërfillës. Personifikimi për të është dhënë më një numër frazash si: *qyteti, pasi kishte njohur shijen e qiellit e të rreziqeve ndërkombëtare, ishte i trullësuar nga të gjitha këto dhe tani ishte tërhequr në gurët e tij të lashtë.* (Kadare 1972: 156); *Qyteti vështronte se si largojë ish-komandanti i tij.* (Kadare 1972: 251); *Qyteti i ngjyer me llum, pas një nate të shqetësuar, u gdhi dhe më i vrenjtur,* (Kadare 1972: 263); *Qyteti gulçonte si në kllapi. Ai pliste përçart.* (Kadare 1972: 267); *Qyteti u drodh si epileptik, u anua, desh ra. etj.* Figurat dhe kalimet e shu mta kuptimore dëshmojnë aftësinë e pashoqe të Kadaresë për përqsasje e lidhje fjalësh a kuptimesh dhe atëherë kur duket e pamundur.

Ligjërimi polisemik dhe krijimi i neologjizmave

Dendur në roman shfaqet loja e hapur që bën autori me kuptimin e fjalëve polisemike. Përftesa më tipike është marrja me kuptim të drejtpërdrejtë e një fjale të figurshme, që është pjesë e togut idiomatik. Në një moment rrëfimtari e tregon në mënyrë artistike kapërcimin e kufij-

ve të kuptimeve të fjalëve: *Një erë e ftohtë, e thatë, frynte vazhdimisht nga gryka veriore. Dëgjoja ulurimën e saj të shtruar dhe në kokë më vërvitej pa asnjë shkak shprehja “fjalët i merr era”, që kisha dëgjuar në mëngjes.... Fjalët filluan të çliroheshin nga kuptimi i tyre i përditshëm. Shprehjet e krijuara nga dy- tri fjalë filluan të zbërtheheshin në mënyrë torturose. Në qoftë se do të dëgjoja që dikush thoshte “më zien koka”, mendja ime, kundër vullnetit tim, aty për aty përfytyronte një kokë që ziente si vorbë me fasule (Kadare 1972: 96); Vështroja pullazet e pjerrët, duke u munduar të kuptoja se si mund të bjerë në kokë dashuria. Ku ishte ajo ? Ku rrinte përpara rënies dhe si rrokullisej papritur mni kokën e njeriut? (Kadare 1972: 97).*

Veç përdorimit të fjalëve me kuptim të figurshëm dhe krijimit të kuptimeve të reja, krijimi i fjalëve të reja, me mundësi të larta shenjuese e shprehëse përbejnë një nga vlerat e diskutueshme në roman. Janë të shumta mënyrat fjalëkrijuese që përdor autori, por e rëndësishme është se të gjitha tërheqin vëmendje dhe na bëjnë të mbajmë frymën sa herë hasim fjalë që nuk i kemi dëgjuar më parë. Fjalë si: *i mosqenë, mbipetk, tymtar, mishtar, gurëri, baltërim, vراسi, fortashtrojë, rrokafundi, shkurnajës, ashpërimën, trupëzimin, cungishëm, rrëshqanthi, krimbdëgjimi etj.* tregojnë aftësinë e autorit për të përdor fjalë të reja me shkallë të lartë shënuese eshpëshë. Madje hasim dhe neologjizma, të cilat janë sinonime mes tyre. Për të emërtuar njerëzit që

ikin nga qytetit në pragun e pushtimit të ri, Kadare përdor një varg fjalësh të reja si : *mërguesit, ikanakët, shkularakët, plangshkulurit.*

Konklozione

Shumë nga tiparet stilistike që përmendëm, për natyrën dhe vlerat që mbartin kërkojnë një trajtim më të hollësishëm, por hapësirat e këtij punimi nuk na e lejojnë. Ky roman është një nga veprat thelbësore në krijimtarinë e Kadaresë, por pa frikë mund të themi se është pjesë e veprave më të lexuara në gjithë letërsinë shqipe, duke lënë gjurmë në edukimin e shijeve estetike të lexuesve. Është romani nga kanë sythulluar shumë vepra të mëvonshme të autorit, megjithatë ai mbetet original dhe i paimitueshëm.

Bibliografi

- DHIMA, Th. (2013), *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe*, Tiranë.
- ISLAMAJ, Sh. (2000), *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë.
- KADARE, Ismail (1972), *Kronikë në gur*, Tiranë.
- LLOSHI, Xh. (1999), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Tiranë.
- SADIKU, E. (1988), Zgjerimi semantik në letërsinë artistike: *Gjuha jonë*, 3; Tiranë.
- SHKURTAJ, Gj. (2009), *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë..

HOW ARE REPRESENTED THE UNSTRESSED FORMS OF PERSONAL PRONOUNS, THE GENITIVE, AND THE VERB "IS" OF ALBANIAN IN SUMERIAN LANGUAGE?

SI PARAQITEN FORMAT E PATHEKSUARA TË PËREMRAVE VETORË, GJINORJA, DHE FOLJA "ËSHTË" E SHQIPES NË GJUHËN SHUMERE?

ANASTAS SHUKE
Studiues/Përkthyes, Tirana, ALBANIA
Email: anastas.shuke@gmail.com

AKTET VII, 3: 246-253, 2014

PËRMBLEDHJE

Në vijim të shtjellimit të argumenteve për lidhjet gjenetike të shqipes e shumerishtes, prejardhja nga shumerishtja e paradigmes së foljeve "jam" dhe "kam" na mundëson sqarimin e zhvillimit historik të tyre në përputhje me ligjësitë e ndryshimeve morfonologjike të pranuar për shqipen. Paradigma e foljes jam duket ka për temë/rrënjë vetën e 3-të njëjës që paraqitet prej togut a.ni të shumerishtes. Gjithashtu paralelizmi i formave të patheksuara të përemrit vector, veçanërisht e vetës së 3-të njëjës "e" me rasën ergative të shumerishtes, dhe i gjinore shumere me "-ak", si mbaresë edhe në shqip e barasvlershme me gjinoren e sotme të saj, janë argumente të lidhjes gjenetike mes dy gjuhëve. Artikulli sjell ndihmesë në historinë e gjuhës shqipe dhe në marrëdhëniet ndërgjuhësore të saj.

Fjalët çelës: shumerisht, shqip, përemër vector, gjinore, folja jam

SUMMARY

Following the representation of the arguments on genetic relationship between Albanian and Sumerian languages, the Sumerian origin of paradigm of the verbs "to be" and "to have" enables us the argumentation of their historic development according to the accepted rules of morphonetic changes of Albanian. The paradigm of the verb "to be" seems to have as theme/root its 3-rd person singular, represented by the a.ni copula of Sumerian. Also, the Sumerian parallel of unstressed forms of personal pronouns of Albanian, especially 3-rd person singular "e" with Sumerian ergative case, and the Sumerian genitive with "-ak", as an Albanian ending that equals the present Albanian genitive, all are arguments to the genetic relationship of both languages. The article brings an aid in the history of the Albanian language and its inter-linguistic relationships.

Key words: Sumerian, Albanian, enclitic copula, genitive, stabilizant, pronoun

Gjuha shumere vijon të mbetet e paklasifikuar në asnjë grup gjuhësor. Studimi i saj ka kaluar përmes filtrit të njohurive për persishten nga e cila është rindërtuar e kuptuar akademishtja dhe, nëpërmjet kësaj, vetë shumerishtja. Për rrjedhojë, si gjuhë e vdekur prej 2000 pr.k, shumerishtja mund të mos jetë kuptuar aq sa duhet për të patur një analizë të sigurtë e të saktë të tipareve të saj në të gjitha rrafshet. Mungesa e

klasifikimit dhe këmbëngulja e përgjithshme për të mos konsideruar më tej ndonjë lidhje gjenetike të shumerishtes me gjuhë të tjera e ka vështirësuar edhe më, vetë studimin e kësaj gjuhe. Ky veçim i plotë, edhe nga gjuhët e afërta gjeografikisht, ka sjellë njëkohësisht edhe nxitjen e studimeve krahasuese me gjuhë të veçanta të grupeve të ndryshme, në ndonjë rast edhe me proto i.e, si M. C. Vidal, i cili arrin deri aty sa thotë

se “asnjë gjuhë tjetër nuk është më afër shumerishtes sesa indoevropianishtja”. Në këtë linjë është edhe krahasimi fillestar i shumerishtes me gjuhën shqipe (Shuke 2010), si dhe punimi në vijim, që kanë për qëllim vërtetimin e lidhjes gjenetike e vijimësisë shqip - shumerisht (gjuhë e shkruar që prej 3200 pr.k) që do të na ndihmonte ta dokumentonim dhe vendosim mbi baza më të drejta etimologjike zanafillën, historinë, dhe zhvillimin e mëtejshëm të shqipes, e do jepte një ndihmesë ndoshta të pazëvendësueshme edhe për studimin e vetë shumerishtes.

Paradigma e foljes *jam*

Sqarim historik i ndërrimeve morfonologjike të vëna re për foljen *jam*, në raport me gjuhët i.e. kanë qenë objekt i studimeve të shumta si ato të Bopp-it, Meyer-it e shumë të tjerëve. Megjithatë, çështja e ndërrimit a>e në v. 2 ndaj v. 1-nj, prania e tingullit -sh- në disa forma e mungesa në të tjerat, si dhe nistorja â- në v. 3 njëjës nuk është sqaruar ende. Në tërësi, përfshirë prejardhjen e pranuar të temës *je-*, si refleksi i **es-*, çështja e zanafillës së paradigmes së foljes *jam* nuk është sqaruar ende si etimologjikisht dhe për ndërrimet morfonologjike.

Si folje ndihmëse kjo është ruajtur për shkak të dendurisë së përdorimit e s’mund të jetë refleksi prej i.e. **es-ti* dhe as nga latinishtja *est* që do të jepnin *isht/ishtë*. Problemi është tek â-hundore që nuk mund të jetë refleksi i një e-gojore (*est*); ajo kërkon praninë e një hundoreje *n*.

Pederseni e nxjerr prejardhjen e formës âshtë nga togu **en esti* – “brenda është”, ku hundorja *ê* çon në â- (geg), *ë*- (tosk). Por ekzistenca e një togu të tillë, zëvendësimi i foljes prej tij, dhe përngjitja hundorizuese që e kërkon theksin mbi ndajfoljen *en*, nuk mund të arsyetohen. Gjithashtu përngjitja duhet të ndodhte në një periudhë shumë të hershme, që pas saj të binte e- tek esti për të mos patur rotacizëm, dhe aq i vjetër ky tog s’mund të jetë. Togu **en esti* nuk mund të jetë burim i *âshtë*, edhe sepse latinishtja duket të jetë një degëzim i gjuhës së hershme i.e., ndërsa lidhja shumerisht-

shqip, të paktën këtu, paraqitet më e drejtpërdrejtë.

V3-nj

Zanafilla e paradigmes së foljes *jam*, duket të kalojë nga përdorimi i shpeshtë në shumerisht i togut *a.ni*, të cilin mund ta konsiderojmë si tog anaforik, e që ndoshta është pikërisht ajo ç’ka kërkonte Pederseni kur arriti deri tek propozimi **en esti*. Këtu *a-*, që lexohet *ash* kur rrokja pasardhëse nis me zanore, quhet stabilizant fjalformues apo prapashtesë e foljes që krijon emra e mbiemra foljorë, sipas modelit të njohur kuptimor: “*emri që vepron është (ky)*”, - *the noun that verbs* (Halloran, 1-ThSLa). Pra, folje+a/ash = emër foljor. Duke patur parasysh edhe ndërtime të tjera në shumerisht ku përdoret *a/ash*, si dhe plot shembuj të shqipes si *ndaj>ndar.ës, mble-dh>mbledh.ës, gërmoj > gërmu.es, çpoj> çpu.es, ndjek>ndjek.ës, pres>prer.ës, shtyp> shtyp.ës, shikoj>shiku.es, mbaj /bart> (m)bart.ës*, etj, mund të pranohet njësia e “stabilizantit” *a/ash* të shumerishtes dhe foljes *a/ash/asht/ ë/ësh/është* të shqipes. Përbërësi *-ni* (ni, -i₃, n- janë e njëjta shenjë dhe tregojnë distancë nga folësi, > v.3 njëjës (Halloran 183, 117); e kundërta mu- afërsi, > v.1 njëjës) paraqitet si me vlerën e dëftorit *ai*, e si vetori v.3-njëjës – *ai* (Halloran, 117 193, 194), dhe duket të jetë i njëjtë me përemrin e pakufishëm *i/ni/nji/një* në shqip, që si përemër me kuptim anaforik e përmban sema ntikisht edhe dëftor/vetorin *ai*. Togu anaforik *a.ni* në shumerisht mendohet se ka kuptimin *i,e tij/saj his/her* (Halloran, 184), por *a-* këtu mendohet si zanore që lehtëson shqiptimin, pa ndonjë vlerë kuptimore, dhe kuptimi bartet vetëm nga *-ni*, e madje nga *-n-* (D. Foxvog, 46). Pra, është i mundur kuptimi literal ***a.ni / ash.ni = është ai/ajo/dikush***, që përbën v. 3 njëjës të eptimit të foljes *jam* (sh. më poshtë për -t tek *asht*).

Vendosja enklitike në togun *a.ni* e përemrit – *ni*, që është këtu në rolin e kryefjalës, nuk ka kundërshti me rendin e fjalëve në fjalinë shumere (Hayes, 13), ku kallzuesi ka përpara kundrinën. Gjithashtu, në mjaft shembuj (mbishkrime, dedikime) të dhënë nga Hayes dhe Foxvog duket

e mu ndshme mungesa e kryefjalës, gjë që përputhet me ç'na thotë Demiraj mbi vendosjen e kundrinës para kallzuesit dhe mospërdorimin e kryefjalës në shqipen e vjetër (Sh.Demiraj³, 120).

Nisur nga ngjashmëritë fonetike me eptimin e foljes *jam* në gjuhët shqipe, sanskrite, greke e latine (E. Likaj, 17), njësia e stabilizantit *a/ash* të shumerishtes me foljen *a/ash/asht/është* merr rëndësi edhe sepse *a/ash* duket të jetë fillesa e eptimit të foljes *jam* apo rrënja/tema e saj, e përdorur për të trija vetat e njëjësit në shumerisht e shqip. Veç kësaj, tingulli homorganik *m* duket merr pjesë në v.1 (njëjës e shumë) të shumerishtes *am₃* si dhe të gjuhëve të mësipërme, e po ashtu tingulli *t* për vetën e dytë e të tretë, (sh. më poshtë).

V2-nj

Tingulli *t* në këto gjuhë duket të jetë mbetja e fjalës shumerisht *ti=jetë*. Shenja kunjiforme $\rightarrow\leftarrow$ (*til₃*) ka leximin e shkurtuar *ti=jetë* dhe leximin e plotë $\rightarrow\leftarrow$ *til=shigjetë*. Dallimi kuptimor mes *ti* dhe *til* del duke veçuar kuptimin e *l-ë* si afër me *ik/heq* ku forma e *L* me dy vija kunjiforme pingule me njëra-tjetrën, tregon grafikisht kthesën apo ndërprerjen e veprimtimit, pra, *L* është paraqitja grafike e foljes *lë* ose *heq/ik*. Në shumerisht kemi shenjën \uparrow *la₂* = *lë/vë* (mënjane), *heq/eq/ik*, zvogëloj, shenja minus, (sh. edhe Halloran, 156).

Ndërsa, *ti=jetë* mundet sema ntikisht të jetë burimi i tingullit *t* dhe i përemrit vector *ti*, e bashkë me *a/ash* të përbëjë burimin e v.2 të foljes *jam*: *ash.ti* > *a.ti* > *e.ti* > *ti.e* > *ti.je*, në ngjashmëri fonetike edhe me eptimin në sanskritisht *asi* (*as.ti*). Mundet që *a.ti* të jetë kuptuar më pas si *ti=jetë*, pra: *ash+ti/tëj=ti/tëj*; në fakt, *ti* është dokumentuar me kuptimin jetë prej 3000 pr.k sipas Falkenstein; shtimi/rënia e *a* mund të shpjegohet edhe me zhvillimin ciklik përsëritës të gjuhës.

Kalimi *a* > *e*, siç haset edhe në foljet *rrah-rreh*, *vras-vret*, *flas-flet*, *ngas-nget*, duket të jetë për shkak të metafonisë së *a-* që vjen nga *-i* e gjatë e rrokjes pasardhëse *-ti*. Vini re edhe sanskriten *vratjō-vras* me *vratī-vret* ku tek *vratī*, që mund ta ndajmë *vra.tī* sipas shqipes, del që *ti*

duhet të ketë pasur i të gjatë *tī*, e cila mund të lidhet edhe me leximin e gjatë *til* të shenjës *kf* të shumerishtes (në dialektin geg *ti del tej/tëj*), pikërisht si të vinte nga *til* > *tej/tëj*, ku *l>j* dhe *ī* atone fundore u reduktua *-ī* > *-ë* Të gjitha foljet shëmbuj të paraqitura këtu janë folje të fondit i.e. të shqipes dhe vetë metafoia është veçori e pak gjuhëve i.e. Diftongimi *e* > *je* është bërë për të zhdukur hiatin si te *at - i jati*, ndoshta pas përdorimit *e.ti* > *ti.e* > *ti.je*.

V1-nj

Në shumerisht togu *am₃* i mbiqajtur *enclitic copula*, – *tog foljor fundor*, mendohet si v.3 njëjës e foljes *jam* (Hayes,144). Togu *am₃* përbëhet nga shenjat kunjiforme $\uparrow\downarrow$ $\rightarrow\leftarrow$ A.AN. Para 2350 pr.k. ka qenë AN, shtimi i *a=A* është i periudhës akade; shenja e Zotit $\rightarrow\leftarrow$ merr këtu leximin *mi*, dhe *mu* në dialektin ES (Halloran, 171, 176); kuptimin e bart *mi(mbi)* = AN, *ash.mi=A.AN* $\uparrow\downarrow$ $\rightarrow\leftarrow$; *mbi* lidhet me AN=qiell (*a.n.a.lt*; *l(a)t*). Por dihet nga teologjia se shkrimi O.ON mbi figurën e Krishtit përkthehet *unë jam*. Paralelizmi fonetik me shenjat përbërëse të *am₃* – A.AN, nga ana e formës, e bën të mundur njësimin kuptimor, pra, A.AN=O.ON, si të ish një dialekt i shqipes që ka ndërruar një *a* para-latine në *o* sipas modelit të serisë së gjatë të zanoreve, që gjendet edhe sot si *ô* e hundorizuar në dialektin e Tiranës. Mbi këtë bazë, si edhe për shkak të pranisë së tingullit homorganik *-m* (*mu*, *im*, *me*, *my*, *mio*, *etj.*), si edhe në v.1 njëjës e shumë në të gjitha gjuhët krahasuese i.e. *am₃* nuk mund të jetë v.3 njëjës, por është v.1 njëjës, siç del edhe nga thellimi në disa shëmbuj të dhënë nga Hayes e Foxvog.

Përbërja e *am₃* vjen nga përngjitja e leximeve të shenjave *A=a* dhe *AN=mi/mu*, *a + mi/mu* > *am₃*; pra kemi: *a + mi/mu* > *a.mi/a.mu*, ku tek *a.mu>am.u>jam.u>jam.un* mund ta ketë burimin edhe *u>un>unë*. Duket se *j-* edhe këtu është shtuar për të zhdukur hiatin pas përdorimit *u.am*, dhe *-n* për të shprehur një *û* hundore. Pra, v. 1 njëjës *am₃* e shumerishtes mund të jetë burimi i v. 1 njëjës të shqipes, që në ngjashmëri fonetike me eptimin në sanskritisht *asmi* është zhvilluar *a.mi/mu* > *a.mu* > *am.û* > *û.am* > *un.jam*.

Nisur edhe nga ç'na thotë teologjia, v.1 njëjës *ash.mi/mu* > *am₃* > *jam.û* duket të jetë forma më e parë zanafillore e paradigmës së foljes *jam*, që na mbështet edhe qënien e *a/ash* si tema apo rrënja e kësaj paradigme.

Lidhur me v. 3 njëjës mund të themi se togut *a.ni*, më pas (ndoshta pas formimit të v. 3 shumë), iu shtua *-ti* për analogji me v. 2 njëjës: *a.ni* > *a.ni.ti* (kuptuar si *a.ni.jet*), e cila pas asimilimit të *n* në *â* hundore mori përsëri *sh* (nga *a=ash*), dhe njëkohësisht u theksua *â*-ja hundore, u asimilua *i*-ja e mbetur nga *ni*, dhe *i*-ja e gjatë fundore e *ti* që humbi theksin, u reduktua në *-ë* ose u asimilua, pra, ***a.ni.ti* > *â.i.ti* > *âsh.ti* > *âsht(ë) / ësh(t)ë***. Humbja e kuptimit të *ni* ndoshta shtoi përsëri një tog anaforik *a.ni*, që paralelizoi me shtimin e *a/ash* në rastet kur ka humbur kuptimi i qartë i termit, si te AN>A.AN. Ky tog *a.ni* i shtuar, pas hundorizimit të *â* u reduktua në *âj*, pra, ***asht+a.ni* > *âsht+â.i* > *âj.âsht***. Kështu, zanafilla dhe zhvillimet morfonologjike të v. 3 njëjës, ku merr përgjigje prania e *â*, *sh* dhe *t*, duket ta kenë bazën tek shumerishtja, me togun anaforik *a.ni* dhe me shtesën *ti* për analogji me v.2: *a.ni* > *a.ni.ti* > *âsht+a.ni* > *âsht + âj / ësh(t)ë+aj*, në ngjashmëri fonetike edhe me eptimin në sanskritisht *asi* (*as.ni*).

Lidhur me numrin shumë, duke patur parasysh se në shume- risht, veç formës me prapashtesën *-ene*, shprehja e shumësit me përsëritje është forma më e dukshme dhe më e pranuar (Hayes, 84, 200), mund të arrijmë në formën e parë zanafillore të shumësit për foljen *jam*, atë të v. 1 shumë. Nga v. 1 njëjës *am₃* < *am(i)* kemi shumësin *ami+ami* që më pas nga përdorimi i shpejtë ndryshoi ndarjen e morfemave në *am.iami*; këtu *ia* u diftongua dhe duke u theksuar dha *am.jami* e më pas u asimilua *am* si përsëritëse e panevojshme e v. 1 njëjës, pra: *jami*>*jem*, që përputhet me mendimin e La Pianës I cili mund të qëndrojë nëse *-l* fundore nuk ka rënë para metafonisë *a>e* sepse *-l* ka qenë e theksuar. Ky theks tek *mi* (ku *l* është zanore e gjatë) është i mundshëm se *mi* ishte bartësja e kuptimit të 249are tek *am<a.mi – mbi*.

Metafonia *a>e* ka ndodhur për shkak të *i*-së së gjatë tek *mi*.

Arrijmë kështu në tabelën krahasuese të zhvillimit historik të paradigmës së foljes *jam* për kohën e tashme të mënyrës dëftore, për gjuhët shumerisht, shqip, sanskritisht, greqisht, latinisht. Tabela pasqyron raportin kohor pra, rradhën e prejardhjes, shqipja pas shumerishtes:

Su merian	Alb anian	Sa nskrit	Gr eek	L atin
<i>am₃</i> (A.MU)	<i>jam</i> u(n)	<i>as</i> <i>mi</i>	<i>ei</i> <i>mi</i>	<i>s</i> <i>um</i>
<i>a.ti</i>	<i>je ti</i>	<i>asi</i> (<i>as.ti</i>)	<i>ei/</i> <i>essi</i>	<i>e</i> <i>s</i>
<i>a.ni</i> .ti (a.ni /a.i)	<i>âsh</i> t.aj (â.i)	<i>asi</i> (<i>as.ni</i>)	<i>est</i> <i>i</i>	<i>e</i> <i>st</i>
<i>ami</i> +ami	<i>jam</i> i> <i>jem</i>	<i>s</i> <i>mah</i>	<i>ei</i> <i>mes</i>	<i>s</i> <i>umus</i>
<i>a.ti</i> +a.ti?	<i>jen</i> (<i>i</i>)	<i>st</i> <i>hah</i>	<i>est</i> <i>i</i>	<i>e</i> <i>stis</i>
<i>a.ni</i> +a.ni	<i>jan</i> > <i>janë</i>	<i>sa</i> <i>nti</i>	<i>ea</i> <i>si/eisi</i>	<i>s</i> <i>unt</i>

Paradigma e foljes *kam*

Për prejardhjen e foljes *kam* është hedhur mendimi se vjen nga folja *jam*. Duket se edhe paradigma e *kam* rrjedh nga shumerishtja dhe është formuar nëpërmjet fjalës *ki = tokë* duke u përngjitur në paradigmën e foljes *jam*. Në shumerisht *ki = ke* (*i<>e*), *ki* mund të zëvendësojë një emër të përveçëm (PN), pra, duket të jetë e njëjtë me përemrin dëftor të shqipes *ki=ky*. Dihet se kuptimi bartet nga bashkëtingëlloret dhe, siç duket në këtë rast, nga *k-*. Një argument do ishte arsyetimi se fillimisht ajo që u nda mes njerëzve në imja dhe jotja ishte toka – *ki*. Atëhere mund të arrijmë në zanafillën e formimit të foljes ndihmëse *kam*, tema zanafillëse e së cilës u krijua *mbi* bazën e foljes *jam* duke i shtuar asaj obje ktin e pronësisë, - tokën *ki* ose *k-* (*ki/ke<>ki₄/ke₄*):

kam < **k.am** < **k.a.m** – këtë/ky/kjo asht mu – kjo asht m u - kjo asht e imja = *kam*.

Sipas parimit të analogjisë nga folja “jam” duket të jenë zhvilluar “ke” dhe “ka”: **e.ti** > **k+e.ti** > **ke ti**

a.ni > **k+a.ni** > **ka.ni** > **kâ.i** > **ka ai**

e po kështu edhe në shumës.

Format e paraqitura të prejardhjes së paradigmes së foljes jam të kohës së tashme njëjës, gjejnë përputhje në përfundimet e Kurylowcz. J. (1977, *Probleme të gjuhësisë indoevropiane*, sipas E. Likaj, 115) mbi bu rimin e mbaresave të eptimit i. e.: v. 2 – t^h < > ti, dhe v. 3 – t < > t. Gjejmë përputhje edhe me përfundimet e Erhart. A. (*Das indoeuropäische*, E. Likaj, 116) mbi ekzistencën fillestare të mbaresës -t, e cila del më pas si –st, e më pas ndahet përsëri në –s e –t, siç ësh të e mundshme po të kihet pa rasysh përbërja e paradigmes së foljes *jam* shumerisht/shqip në zanafillë.

Mbaresat i.e. të paradigmes së foljes jam (v. 2 e v. 3) duket kanë të njëjtin burim, foljen *është* me format e saj zanafillore *a/ash* (stabili- zanti *a/ash*), përemrin vetor / dëftor / anaforik “ti” = jetë në shumerisht, dhe përemrin e pakuf./dëftor/vetor/ anaforik “ni”, pikërisht siç mendon Erharti mbi ekzistencën e *s*, *t*, *st*, si dhe përngjitjen e “rrënjëve përem- rorë me përbërje *n+V* dhe *t+V* (*V* = zanore)” (E. Likaj, 116), pra, të “*ni*” dhe “*ti*”.

Gjinorja me –ak

Formimi rasës gjinore në shumerisht duket i ndryshëm nga gjuhët i.e. një ndërtim sintaksor më vete i ndërfutur në sistemin rasor (Hayes, 66). Gjinorja i.e. si rasë që shpreh marrëdhëniet në një grup emëror, shprehet sot me mbaresat përkatëse dhe me ndihmën e nyjeve pronore, si *i*, *e*, *të*, *së* në shqipen. Por në fazën paragamatikore gjinorja i.e. shprehet me pasvendosje e përngjitje të fjalëve (Likaj, 34), psh. dëftorit anaforik (*ki*), fo rmë që duket përdoret edhe në shumerishten, ku gjinorja realizohet kryesisht me prapashtesën –ak, (Hayes, 42). Kjo në kunjiform paraqitet si kombinim pjesësh të dy shenjave, –*a.k* < *ma.ki₄/ke₄*, që përbën një nga shembujt e

shumtë që leximet e pranuar mund të mos ndahen sipas leximit të shenjave të veçanta (apo emrit akad të tyre). Leximi i propozuar i shenjës *ki₄* në *ke₄* nga Kramerer më 1936, vendosur mbi bazën e kontekstit, nuk gjendet në listat leksikore shumerisht-akadisht. Përemri dëftor *ki/ki₄>ki=ky* me leximin e dytë *ke₄* duket paraqet femëroren *ke₄* > *kjo*, zhvillim që duket i mbështetur fonetikisht, *e* > *ja* > *jo*, pra, **ki / ki₄** > **ky** dhe **ke₄** > **kjo**. Sipas Halloran, 137 *ki* zëvendëson një emër të përveçëm, që nënkupton dëftorin *ki = ky*; **mu, ki, ti, ni**, duket të jenë **dëf- torë zanafillës** anaforikë të shqipes, burim i p. vetorë, f. th. p. v, f. p. p. v, dhe dëftorëve të sotëm. (sh. edhe Sh. D³, 70). Këtu duhet patur parasysh se një rrokje e caktuar ka qenë shkruar me disa lloj shenjash apo kombinime të tyre, bazuar në parimin rebus, që nënkupton një shkrim strukturalisht të plotë e të fonetizuar ndoshta që në fillimet e kunjiformit.

Edhe në shqip kemi përdorimin e prapashtesës –ak si psh: durrsak, ushtarak, fshatarak, vezake, etj., të cilat semantikisht shprehin rasën gjinore apo njëfarë raporti pronësie: i Durrsit, i ushtrisë, i fshatit, (me formën) e vezës. Duket qartë përkatësia e gjinisë *ak*-mashkullore dhe *ake*-femërore me burim shumerishten. Edhe në shqip këto fjalë me prapashtesën –ak mund të lakohen në të gjitha rasat duke marrë mbaresat përka- tëse, siç mendohet se ndodh edhe në shumerisht (Hayes, 66), gjë që tre gon se kjo formë e barazvlershme me gjinoren është, si në shumerisht, një ndërfutje në sistemin rasor, karakteristikë kjo e gjuhëve aglutinative siç konsiderohet shumerishtja.

Nga ana tjetër, shumerishtja duket të na japë çelësin e zbërthimit eti mologjiko-semantik të shqipes në morfema më të thjeshta (deri në fonema), i cili për prapashtesën –ak ësh të: *a.k(i)=asht.k(y)*, si psh. durrsak= i Durrsit *a(sht) k(y)*; vezake = e vezës *a(sht) k(jo)*. Ky zbërthim tregon se prapashtesa –ak përbën, siç thotë Hayes, një ndërtim sintaksor, një fjalë. Mundësia e një zbërthimi të tillë deri në fonema, siç pamë edhe gjatë analizës së foljeve *jam* e *kam*, shfaq thelbin aglutinativ/përngjitës të gjuhës në përgjithësi dhe të shqipes në veçanti.

Përfundojmë se gjinorja e shumerishtes, si ndërftje e njëjtë në shqipen dhe etimologjia e saj përmes shqipes është një argument tjetër, sintaksor, për qënien e saj gjuha ba- zë i.e, dhe për lidhjet gjenetike me shqipen.

Mendohet se edhe e_2 = shtëpi, tempull, familje, fis, shtëpiake, paraqet një formë pronore (gjinore), duke pranuar se (ndoshta) shumerishtja s'e ka fjalën *shtëpi* < *është.pi* < *sht.e.pi* < *sh.pi* < *sh.e.pi* < $e_2(pi)$. Kjo formë e gjinore është krejt e njëjtë në shqipen. Për shtëpiake përdoret ndërtimi me emrin e burrit si "moj e Kozmait"; po kështu për shtëpinë, fa- miljen dhe fisin, duke patur parasysh se leximi i *e* është i pasigurtë dhe mund të jetë edhe *i*. Pra, shenja e_2 mund të paraqesë një gjinore nor- male i.e, si e shqipes, me nyjen pro- nore *i* ose *e*, ku nuk përmendet objekti i "poseduar", por vetëm "pose- dues". Edhe ky rast është një përkim sintaksor mes dy gjuhëve, që nënkupton karakteristika të mundshme i.e edhe të shumerishtes.

F.P.P.V "e" në shqipen kundrejt rasës ergative dhe DP-ve në shumerishten.

Për format e patheksuara të për- emrave vektorë të shqipes nuk është sqaruar ende kënaqshëm histori- kisht, zanafilla dhe rrethanat sintaksore të krijimit dhe përdorimit të tyre si përsëritëse të kundrinës së drejtë e të zhdrejtë. Nga ana morfologjike është i paqartë burimi dhe koha e zanafillës veçanërisht për vetën e tretë njëjës e shumë *e, i, u, i*, por mendohet se janë mbeturina të një vektorit të vetës së tretë me origjinë dëftori, ndërsa dy vetat e para janë përfutur nga format e plota përkatëse (Sh. Demiraj³, 113, 114, 146). Kujtojmë se në shqipen e hershme kundrina e shprehur me përemër vektor vendosej pandërmjetshëm pranë foljes, kryesisht para saj (Budi, Buzuku). Forma e patheksuar përdoret në fjali ku theksi nuk bie mbi kundrinën që përsërit, ndërsa forma e plotë në fjali ku theksi bie mbi kundrinën (apo formën e theksuar). Vjetërsia dhe evolucioni fonetik i hershëm i f.p.p.v. dëshmohet nga vendosja pranë foljes dhe nga përbërja fonematike e përgjithësuar në të gjitha të folmet e shqipes (*më, të, e, i, na, u, i*) përfshirë trajtat e përngjitura *më+e=ma, të + e = ta, i+e=ia, u+e=ua,*

i+i=ia, u + i = ua (Sh. Demiraj³, 121). (Përgjithësimi i k. zh/k.d_{1,2} –i plotë; k.d₃–kusht theksi). Sa i përket rendit, f.p.p.v kallzore vendoset më afër foljes (më e lidhur me të) se ajo e dhanores, pra, në rastin e f.p.p.v të përngjitura ajo e dhanores vendoset para f.p. të kallzores. Pra, nuk mund të përjashtohet se, në kohën e krijimit të formave të patheksuara, kundrina (dhe përemri vektor në funksion kundrinor) në gjuhën shqipe vendosej më fort para foljes (Sh. Demiraj³, 120). Duke ditur edhe se, në shqipen e hershme, kryefjala zakonisht nuk shprehej, atëherë mund të supozohet se në kohën e krijimit të f.p. në gjuhën shqipe fjalia mund të niste me kundrinën (emër, përemër, + f.p.) dhe vijonte me kallzuesin, ndërsa kryefjala mund të ishte në fund, pra duket të ekzistonte rendi kundrinë-kallzues (OV) ose kundrinë-kallzues-kryefjalë (OVS).

Për shumerishten mendohet se rendi i patheksuar i fjalëve në fjali është kryefjalë – kundrinë - kallzues, SOV, pra, mund të kemi një përputhje të pjesëshme në rast se fjalia ka kryefjalë, dhe të plotë kur ajo mungon, OV. Po t'i rikthehem arsyetimit të Hayes, 9 mbi ergativitetin e shumerishtes (A.Shuke, 2010), mund të themi se rasa ergative që aty i referohet kryefjalës, duket t'i jetë referuar kundrinës si një fonemë e veçuar që renditet para foljes dhe pas kundrinës, por e konsideruar si mbaresë e saj për shkak të vështirësive në rindërtimin morfologjik të kunjiformit.

Në shumerisht rasa ergative shënohet me "mbaresën" –e, përfaqësuar zakonisht nga pjesa e dytë e shenjës ke_4 ku *k* është pjesë e prapa shtesës –ak, ku *a/ash* –stabilizan- ti/folja është. Sipas Hajesit efekti i ergativitetit, është një përcaktim i dyfishtë, apo kuptim më i mirë, më intuitiv i rolit veprues të agentit, kundrejt rolit të pacientit në një veprim të kryer. Shembullin e Hayes (*the boy rolled the ball down the hill*) mund ta shkurttojmë në shqip, pa hu- m bur kumtin që na intereson, deri në: *topin e rrokullisi*, ku kryefjala *djali* mungon por nënkuptohet nga mbaresa eptimore e foljes dhe ndryshimi i rendit të fjalëve nuk e ka ndryshuar kumtin. Forma e patheksuar e pë- remrit vektor të v.3 njëjës e na

jep një përcaktim të dyfishtë, veç atij nga eptimi, një kuptim më të mirë, më intuitiv të rolit veprues të djalit, pikërisht siç e ka sqaruar profesor Hayes vetinë e ergativitetit të shumerishtes. Një trajtim të tillë të f.p.p.v e gjejmë edhe tek Sh. Demiraj³, 113, 134, 138, 142 ku ato përcaktohen si *përsëritëse* redundante të kundrinës, si përcaktuese të dyfishta të saj për ta bërë më të qartë kumtin, ose për ta theksuar më shumë objektin e kumtimit në rastin e f.p. të v.1 e v.2.

Pra, mund të themi se në rastin e ergativitetit nuk kemi të bëjmë me *rasën* apo mbaresën ergative –e, që duket t'i referohet kundrinës e jo kryefjalës, por me një element më vete, me formën e patheksuar të përemrit vetor të v. 3 njëjës ë. Në pikëpamje të rasës ergative, *mbaresa* apo f.p. ë i referohet agentit, vepruesit, por me homonimin ë paraqitet edhe *mbaresa* e rasës vendore-fundore që shënon objektin / vendin *mbi/në* të cilin ndodh ngjarja / veprimi, pra kundrinën (D. Foxvog, 54). Në këtë rast duket të kemi përsëritjen e kundrinës me anë të *mbarësës*/f.p. ë, siç shpjeguem më lart. Përputhja fonematike dhe kuptimore e mbarësës ë të rasës ergative me f.p. ë të shqipes dhe homonimia në shumerisht e rasës ergative dhe rasës vendore-fundore shprehur me *mbarësën* ë, tregon se kemi të bëjmë me të njëjtin funksion sintaksor të analizuar nga dy këndvështrime të ndryshme, e raportit me vepruesin dhe raportit me kundrinën. Gjithashtu, *mbaresa*/f.p. ë paraqitet edhe si parashtesë *ergative* e togut foljor (D. Foxvog, 69), që nënkupton se ajo është një element morfo-sintaksor më vete, njëlloj si në gjuhën shqipe.

Paraqitja e saj në kunjiform nga shenja *ke*₄, me leximet *ki*₄, *ge*₂, dhe *kid* (*sipas listave leksikore Akade* (Hayes, 49); *leximi kid mund të paraqesë edhe kallzoren kit/ket>kët/këtë sepse d<>t*), duke patur parasysh edhe qëndrueshmërinë fonetike të shume rishtes ngre mundësinë që këtu të kemi të bëjmë me dëftorin zanafillës *ki/ke > ky/kjo*, që e përmend në mënyrë implicite Demiraj³,146. Prejardhja e f.p. ë duket të jetë prej leximit *ke*, që është burimi i dëftorit të sotëm *kjo* (-e->ja->jo), mbështetur edhe me arsyetimin se ë nënkupton

termin përgjithësues *gjë* në vend të kundrinës konkrete, term i cili është i gjinisë femërore. Madje edhe vetë termi *gjë* duket e ka burimin tek termi shumer *ki(ky)=tokë*, që siç thamë ka dhënë *gji* afër me *gjë* (i>ë), pra, f.p.p.v. e v.3 njëjës ë na risjell/përsërit, *gjë < ki/ke/kit/ket > kët/këtë*, formën e vet të theksuar *këtë*. Tek dëftorët *ki/ni* ndoshta e ka burimin f.p. v.3 njëjës i e dhanores, por për *këtë* duhet një punë e mëtejshme.

Parashtesat e quajtura të *dimensionit* DP në *togun foljor* të shumerishtes, risjellin / rregjistrojnë / lidhin marrëdhëniet e rasave në fjali, në një marrëdhënie të përcaktuar saktë një për një. DP-të përbëhen nga elementë përemërorë dhe mund të jenë edhe të përngjitura, por DP e rasës dhanore është gjithnjë e para, pas saj mund të vijë DP-ja ergative (D. Foxvog, 69), që siç thamë është f.p.p.v e v.3 njëjës ë. Parashtesat DP- duken redundante, apo përsëritëse të panevojshme që nuk përcjellin ndonjë kuptim, por, thotë Hayes, duket se ato ndihmojnë qartësinë e kumtit, që informacioni të mos ngatërrohet (Hayes, 44).

Duket edhe këtu se gjithë ç'thonë Hayes dhe Foxvog për tiparet e DP-ve të shumerishtes, paralelizon me format e patheksuara të përemrit vetor të shqipes siç i trajton Prof. Demiraj, paralelizëm që duket të jetë argument bindës për lidhjet gjenetike mes dy gjuhëve. Megjithatë, problemet e rindërtimit morfologjik të shumerishtes, pra ndarja jo e saktë e fjalëve e bën të pasigurtë tani për tani krahasimin e drejtpërdrejtë të tërë paradigmes së DP-ve të shumerishtes me format e patheksuara të shqipes, gjë që me siguri do të realizohet në të ardhmen.

Përfundime

Me tezën TLN, ku gjuha shumere merret si gjuha bazë i.e., e me lidhjet përkatëse gjenetike të saj me shqipen, nënkuptohet një vijimësi e tillë nga gjuha bazë drejt gjuhëve të veçanta i.e, ku shqipja është gjuha që i trashëgon karakteristikat i.e, më drejtpërdrejt, dhe mbi të gjitha, që përdor fjalë me rrënjët / temat më të shkurtra, deri në fonema me kuptim. Pikërisht *kjo* shkurtësi, që është një karakteristikë e pranuar edhe për shu-

merishten, duket na flet për një gjuhë sintetike-analitike të arrirë, që ia del të kumtojë diçka, më qartë e pa ekuivoqe, më saktë e relativisht më shpejt. Gjuhët motra të gjuhës-bazë si ajo sanskrite, greke, latine duket të jenë në fakt, shmangje nga ecuria e transformimeve gjuhësore të shumerishtes, dhe kjo ka patur ndi kim më pas mbi gjuhën shqipe, për arsye se ato kanë qenë gjuhët e shkruara pas zhvendosjes së kulturës shumere në Evropë prej rreth 2000 pr.k.

Zanafilla shumere e paradigmës së foljeve ndihmëse jam dhe kam, që u jep përgjigje të mbështetur fonetikiht problemeve të

pasqaruara deri më sot mbi origjinën dhe zhvillimin historik të eptimit të këtyre foljeve, duket të jetë argument bindës për lidhjet gjenetike të shqipes e shumerishtes, dhe të qënies së saj gjuha-bazë indoevropiane.

Gjithashtu paralelizmi i formave të patheksuara të përemrit vetor, veçanërisht e vetës së 3-të njëjës “e” me rasën ergative të shumerishtes, dhe i gjinores shumere me “-ak”, si mbaresë edhe në shqip e barasvlershme me gjinoren e sotme të saj, janë argumente të rëndësishme të lidhjes gjenetike mes dy gjuhëve..

PRITJET E LEXUESIT NË DIALOG ME TEKSTIN NË ROMANIN "KUSH E SOLLI DORUNTINËN"

READERS' EXPECTATIONS IN DIALOGUE WITH THE TEXT, "WHO BROUGHT DORUNTINE"

ALTA AZIZI HALUCI

Universiteti 'Ismail Qemali', Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë, Vlorë, SHQIPËRI

Email: altahaluci@gmail.com

AKTET VII, 3: 254-259, 2014

PËRMBLEDHJE

Ismail Kadare është një ndër shkrimtarët të cilët sollën një frymë të re në letërsinë shqiptare. Ndër këto vepra është edhe romani *Kush e solli Doruntinën*, të cilin që nga fillimi deri në fund e përshkon enigma, misteri i ardhjes së Doruntinës. Një mister sa i pamundur, i pabesueshëm duket po aq edhe i mundshëm dhe i besueshëm. Shtrirja e gjithë ngjarjes mbi një enigmë që s'po i gjendet e vërteta është ndoshta arsyeja që e mban të gozhduar lexuesin përgjatë gjithë leximit. Kadare e lë lexuesin në pritje se çfarë do të ndodhë duke e zhytur atë nëpër ide të cilat një lexues mund ta mendojë si një zgjidhje për enigmën. Elementi kryesor që përshkon veprën është besa. Konstandini arriti të mbante besën, u vu fjala në vend, u mbajt premtimi. Po kush e solli Doruntinën? E solli fjala e dhënë, besa shqiptare, një aventurier, apo pengu i një incesti te pakryer? Në këtë vepër do të trajtojmë enigmën që përshkon nga fillimi deri në fund të gjithë romanin dhe si pritet ai nga lexuesi.

Fjalët çelës: lexues, tekst, rrëfim, element i të papriturës, horizonti i pritjes.

SUMMARY

Ismail Kadare is one of the writers who brought a new spirit in Albanian literature. Among these works is the novel "Who brought Doruntina", from the beginning to the end of crosses enigma, mystery of Doruntina arrival. A puzzle as impossible, incredible as it seems to be feasible and reliable. The scope of the entire event on a figure who no one found the real reason is probably that keeps the reader throughout reading. Kadare nailed leaves the reader in anticipation of what will happen by plunging it into the idea that a reader can I think as a solution to the riddle. The main element of the criminal is permeating fode. Constantine managed to keep their word, the word was put in place, held promise. Who brought Doruntine? The given word brought, Albanian fode, an adventurer, or a pledge of imperfect incest ...? In this work, we will treat enigma that runs from the beginning to the end of the novel and all he expected from the reader.

Key words: reader, text, confession, the element of surprise, waiting horizon.

Hyrje

Në çdo vepër të Kadaresë asgjë nuk është ashtu siç duket. Poshtë çdo përshkrimi apo rikujtimi të një historie a të një legjende fshihet një mesazh i cili paraqet realitetin shqiptar. Kur lexon romanin *Kush e solli Doruntinën* që në rreshtat e parë

futemi në mjedisin ku zhvillohet ngjarja e romanit. Paraqitet personazhi kryesor dhe që në kapitullin e parë shpaloset ngjarja, pikëpyetjet dhe detyra e personazhit kryesor. Në roman paraqitet e njëjta fabul me legjendën, por me një subjekt ndryshe.

Kur e lexon për herë të pare, apo kur e lexon një lexues i painformuar të lë përshtypjen e një përralle e cila kërkon që të na çojë në një fund të lumtur. Kadare di ta thurrë shumë bukur një histori të tillë për të shfaqur bindjet e tij që në atë kohë ishin të penguar. Ai ndërthur bukur elementin mitologjik, historik, të trilluar me atë të papriturës. E lë lexuesin në pritje se çfarë do të ndodhë duke e zhytur atë nëpër ide, të cilat një lexues mund ta mendojë si një zgjidhje për enigmën. Por atëherë kur nuk e pret ai sjell një ide tjetër që e mban të lidhur lexuesin.

Personazhet dhe çfarë simbolizojnë ata në roman

Në romanin *Kush e solli Doruntinën* rrëfimi i tij bëhet nëpërmjet dy rrjedhave: të asaj që lëvizë mbi peisazhin e gjallë dhe në atë të rrugëve të errta të territ. Në linjën e parë të rrëfimit hyn personazhi kryesor **Stresi**, i cili është hetuesi i ngjarjes misterioze dhe zgjidhësi i enigmës. Ky personazh është ndërtuar sipas tipareve të një detektivit zhbirues dhe me një konstrukcion shpirtëror dhe psikologjik të ekuilibruar. Ai e ka shumë të qartë që në fillim se historia e ringjalljes është një përrallë, gjithashtu mendon se kjo histori në atë periudhë krize që ndodhej vendi do krijonte rrëmujë të fuqishme. Megjithatë, perspektiva e tij hetuese përqendrohet në një drejtim: i gjalli ka kalëruar me të gjallin. Më vonë do të mendojë se edhe i gjalli me të vdekurin mund të kalërojnë bashkë.

Duke kërkuar t'i japë zgjidhje enigmës ai zbulon dhe thelbin e çështjes: vënia në vend të premtimit të dhënë. Kjo zgjidhje është në pajtim me vizionin e Konstandinit të vdekur dhe me atë të pasuesve të tij të gjallë, pra në pajtim edhe me vizionin dhe filozofinë e Stresit. Kush e sjell Doruntinën Stresit i bëhet e qartë nga biseda me miqtë e Konstandinit. Pikërisht brenda këtij kuadri dhe mbi këtë vizion Kadare e bën më komplekse natyrën e Konstandinit. Konstandini dhe Srtesi janë dy personazhe, të cilët ndërthurin mozaikun kuptimor të ngjarjes, përvijohen si dy shtigje, si dy jehona, një këtej edhe një matanë. Por të lidhura e të mpleksura në mori fijesh të

dukshme dhe të padukshme. Pra, edhe Stresi i gjallë, edhe Konstandini i vdekur, janë pranë e pranë, në një përjetësi të pashkoqur. Doruntinën ka mundur ta sjellë Konstandini, por ka mundur ta sjellë edhe pasuesi i tij i gjallë vetë Stresi. Janë shtigje shumësie këto që shtrihen dhe hapin horizonte të pafund hamendjesh, por vetëm sa për të tërhequr një kërshtëri njerëzore dhe jo për të ndryshuar thelbin e ngjarjes dhe, këtë të vërtetë Kadare e formulon qartë e bindshëm dhe në mënyrë sovranë.

Konstandini na shfaqet si një figurë, e cila transmeton tek lexuesi virtytet e një njeriu patriot, luftëtar i cili ishte i vetmi kundërshtues i ligjësisve politike. Ai përkrahte atë që ishte krejt shpirtërore, e lidhur me ndërgjegjen, e trashëguar nga tradita shqiptare. Ai kërkonte të krijonte një model të veçantë shqiptar, të cilin, Kadare, në vepër e shfaq nëpërmjet fjalëve të Stresit.

Pritshmëria e lexuesit në dialog me tekstin. Elementi i të papriturës

Duke i bërë një analizë të hollësishme shohim që e papritura e ka shoqëruar romanin nga fillimi deri në fund dhe ka bërë të mundur ta shtrijë rrëfimin në një pafundësi refleksesh dhe nuancash për të mos e kufizuar zërin qendror nga rrjedhat anësore. Kjo duket jo vetëm në rrjedhën e ngjarjeve, por edhe në ndryshimet e mendimeve dhe të qëndrimeve të personazheve, veçanarisht të personazhit kryesor, Stresit. Romani është i ndarë në shtatë kapituj dhe është i rrëfyer në vetën e tretë.

Rrëfimtari nuk realizon vetëm misionin e tregimtarit për atë çka di dhe çka sheh, por synon që të deportojë haptazi në thelbin e ngjarjes, të karakterit të personazhit. Ai nuk synon vetëm të krijojë një portret të jashtëm, por paraqet edhe botën e brendshme të personazhit. Me këtë autori na tregon karakterin psikologjik të veprës, duke bërë që të tërheqë më shumë vëmendjen dhe vështrimin e lexuesit më në thellësi të ngjarjes dhe personazheve. Në këtë roman Kadare nuk na bënë një analizë psikologjike të

personazhit por zbulon mirë psikologjinë e personazhit.

Personazhi kryesor i romanit është Stresi, të cilit i ngarkohet një detyrë. Të zgjidhë misterin e ardhjes së Doruntinës. Veç dialogut të pakët që ka në roman me personazhet e tjerë, lexuesit i shpaloset psikologjia e Stresit. Mendimet e tij rreth kësaj çështjeje dhe analizat e të dhënave e çonin atë në krijimin e historisë së mundshme për ardhjen e Doruntinës. Shfaqen siguritë, pasiguritë, luhatjet, dyshimet, bindjet, xhelozia të Stresit të cilat arrihen të zbulohen me anë të zbulimit të ngjarjes.

Do të shohim me kujdes ngjarjet hap pas hapi në të gjithë kapitujt, me komentim përkatës.

Fragmenti i parë: Që në rreshtat e parë të romanit futemi në mjedisin në të cilin zhvillohet ngjarja. Shfaqet personazhi kryesor dhe tregohet problematika e romanit. Ka ardhur Doruntina. Kush e ka sjellë? Kjo është pikëpyetja që e mundon Stresin derisa të gjejë përgjigjen e këtij misteri, i cili sa i pabesueshëm duket, po aq është edhe i frikshëm. Në fragmentin e parë na jepet një Stres që flet ngadalë, i hutuar, i qetë por njëkohësisht edhe i tmerruar. Ai në këto momente nuk duket si një drejtues, por si një mik i familjes, një mik i Konstandinit dhe një burrë i dashuruar pas të bukurës Doruntinë. Komunikimi mes personazheve është jo i plotë, sepse nuk zbulohet misteri.

E papritura shfaqet që në fillim. Ardhja e Doruntinës është një e papritur. Por më shumë e papritur dhe e pabesueshme ishte se me cilin erdhi Doruntina. E papritura dhe habia shfaqet tek Stresi, i cili mori vesh ardhjen e Doruntinës. P.sh.: *'Zonja plakë e Vranajve dhe e bija e saj kanë mbërritur mbrëmë në rrethana misterioze.... –Doruntina? - ia bëri Stresi hutueshëm- Si është e mundur?'* (Kadare 2004:). Ky lajm ishte i papritur por jo i pamundur. Ajo mund të kishte ardhur me bashkëshortin e saj. Kulmi arrihet kur Stresi merr vesh se Doruntinën e kish sjellë Konstandini: *"Konstandini? Po ai ka tre vjet që ka vdekur, bashkë me tërë vllëzërit e tjerë."* (Kadare 2004:). Stresi më shumë se i befasuar ishte i tmerruar. Rrugës për në shtëpinë e Vranajve Stresi imagjinonte skenën e takimit nënë e bijë. Kur

shkon atje ai sheh sy bosh, të llaftarisur, të zbratur, dhe të tronditur. Të cilët nuk i japin asnjë përgjigje veçse e turbullojnë më shumë Stresin.

Stresi shkruan raportin e ngjarjes që kishte ndodhur në shtëpinë e Vranajve. Për Stresin tani kjo histori ishte shumë e errët, dyshuese dhe mendon se ka dy zgjidhje të mundshme: ose Doruntina gënjente ose e kanë gënjyer atë. Elementi tjetër i papritur është se varrit të Konstandinit i kishin lëvizur gurët: *"- Shikoni me kujdes,-tha ai.- Gurët kanë lëvizur...-Vërtet?-ia bëri Stresi."* (Kadare 2004:). Gjë që Stresit i dukej e pamundur që një njeri mund të ringjallej. Të kthehej nga një botë që s'mund të ktheheshe. Tashmë dy pyetje e mendojnë Stresin: kush e solli Doruntinën? Si mund të ringjallet një i vdekur?

Tashmë Stresi nuk ishte më një mik apo një burrë i dashuruar, por një udhëheqës i vendit, një detektiv zhbirues i cili kërkonte me çmos që të zbulonte enigmën e ardhjes së Doruntinës. Ai këmbëngulte në zbatimin e detyrës që i ishte ngarkuar. Përgjigjet e njëjta të Doruntinës e zhysin më shumë Stresin në pakuptimësinë e asaj që kishte ndodhur. E papritur për Stresin ishte se si Doruntina ngulmonte se e kishte sjellë Konstandini. Sado që ishte e pabesueshme dhe ajo nuk i kishte parë fytyrën, sepse e pengonte floku edhe balta, Doruntina ishte e sigurt që ishte ai.

Raporte të ndryshme vinin nga bujtina të cilat tregonin nëse kishin parë ndonjë burrë dhe një grua hipur në një kalë, të kishin kaluar andej mbrëmjen e njëmbëdhjetë tetorit. Krahas kësaj, ndihmësi i Stresit kishte filluar të hetonte arkivin e familjes së Vranajve. Asgjë nga këto lajme s'kishte ndonjë informacion të dobishëm.

E papritur për Stresin ishte vizita e rojes së varrezave, i cili i tregon për mallkimin e Zonjës Mëmë ndaj djalit të saj Konstandinit. Pikërisht dy të diela para ngjarjes Zonja Mëmë kishte shkuar në varret e djemëve dhe kishte ndezur nga një qiri ndërsa në varrin e Konstandinit ndezi dy qirinj dhe e kishte mallkuar atë për besën që s'e kishte mbajtur: *"S'ishte as ligje as vaj i zakonshëm – vazhdoi rojtari- ishte një mallkim. -Mallkim?!-tha Stresi* (Kadare 2004:).

Ky lajm ishte i papritur për Stresin se si një nënë mund të mallkojë djalin e saj. Ky fakt i shton pasigurinë dhe e bën Stresin që të arrijë në kulmin e habitës. Kësaj pasigurie mendoi që do t'i jepte shpjegim po të fliste me Zonjën Mëmë, pasi e kishte harruar ta bënte një gjë të tillë. Rugës për në shtëpinë e Vranajve ai mer vesh që të dyja nënë e bijë kanë vdekur: *“Ç’është kështu? – tha Stresi.- Me duket se po dëgjoj një kujë.... Rrugën për te shtëpia e bëri pa folur...Ka vdekur – mērmēriti Stresi - s’ka asnjë dyshim.....Si është e mundur! – ia bëri Stresi, pa ngadalsuar hapat. Pēshtyma në gojë i ishte tharë dhe qiellzën e kishte bërë helm.”* (Kadare 2004:). Kjo e paritur për Stresin i zhduki të vetmen mundësi që kishte ndoshta për të marrë vesh të vërtetën.

Në kapitullin e tretë zhvillohet varrimi i Zonjës Mëmë dhe Doruntinës. E gjithë miqësia kishte ardhur ashtu si në dasmën e Doruntinës. Por vetëm me një ndryshim dikur u largua larg e martuar dhe një ditë do të kthehej. Ndërsa këtë ditë po largohet e martuar me vdekjen për mos tu kthyer më kurrë. Këtë ditë u duk se sa e madhe dhe e largët ishte miqësia e principatës shqiptare me vendet e tjera të kontinentit. Edhe dasma e Doruntinës u bë për këtë arsye, për të lidhur aleancë me vende të largëta. Katër vajtojcet vajtonin nënë e bijë me një këngë të thurrur mbi gjëmën që u kishte ndodhur. Stresi habitej se sa shpejt hapej lajmi dhe se si njerëzit ishin kaq naivë t’i besonin një historie të tillë.

Një lajmërim i vjen Stresit që duhet të takojë kryepeshkopin. Ç’punë kishte vallë ai? Pse e thërriste në Manastirin e Tre Kryqeve dhe jo të shkonte në selinë e tij në principatë? Ç’ishte kjo gjë kaq me rëndësi? Të gjitha do i zbulonte kur do e takonte. Stesi nuk e kish parë asnjëherë nga afër kryepeshkopin. Ajo çka e habiti Stresin është kërkesa që të zhduket ngjarja e ringjalljes së Konstandinit. Po përse? Ndoshta kulmi i habitës dhe ajo që Stresit iu duk e papritur ishte kur kryepeshkopi i kërkoi që të krijohet ai njeri që e solli Doruntinën:

“Duhet bërë edhe më, kapiten. Dhe kjo arrihet vetëm me një mënyrë: dashnori apo aventurieri. Të kërkohet me këmbëngulje, me ngut, kudo. Të kthehet bota përmbys gjersa të gjendet. Dhe në

qoftë se s’gjendet, të krijohet. –Të krijohet?!” (Kadare 2004).

Kjo e turbulloi më shumë Stresin. Tashmë ishte më shumë i detyruar që të zbulonte të vërtetën e të mbyllte gojën e të gjithë njerëzve që besonin në ringjalljen e Konstandinit. Ai donte vetëm të ishte i drejtë dhe të kryente detyrën e tyre dhe mos të futej në probleme.

Stresi sa vinte e bëhej më nervoz. Asnjë e dhënë që të çonte në zgjidhjen e misterit. Dy burra të rinjë kanë ardhur nga larg. Janë dy kushurinjtë e bashkëshortit të Doruntinës. Stresi më në fund mendoi se gjithçka do mund të zgjidhet. E papritura për të gjithë ishte se Doruntina para se të ikte kishte lënë një letër. Çfarë shkruante në atë letër? Mbase në të tregohet gjithçka. Doruntina tregon se me kë ka ardhur dhe se nuk ka dashur që të qëndronte më atje. E kish marrë malli për familjen: *“Po iki me tim vëlla Konstandinin”* (Kadare 2004:). Në fund të letrës shkruhej *“në qoftë se”*. Çfarë ka dashur të thotë? Ka të bëjë me të vërtetën. Vëllezërit thanë që Doruntina është nisur: *“Më njëzet e nëntë shtator, - u përgjigj njëri prej tyre”* (Kadare 2004:). Kjo ishte e papritur, sepse Doruntina kish thënë se kishin ecur vetëm një natë të gjatë, por në të vërtetë ata kishin udhëtuar plot trembëdhjetë ditë. E papritur tjetër është incidenti mes Konstandinit dhe bashkëshortit të Doruntinës, ditën e dasmës.

Në mendjen e Stresit tashmë bluanin shumë gjëra. Në një farë mënyre Stresi ishte i çliruar se mundësitë që Doruntina mund të ketë ardhur me dashnoriin e saj ishin më të mëdha. Këto mendime ia prish ndihmësi i tij me lajmin që i solli pasi kishte studiuar arkivin e familjes së Vranajve. Këtë përfundim e arriti pasi kishte lexuar letrat që Zonja Mëmë i kishte dërguar mikut të saj kont Topia:

“Hollësira në letër nuk ka, por, po ta lidhim këtë me të tjera fakte nga letrat e mëvonshme, e sidomos me përgjigjen e kontit Topia, del e qartë se kemi të bëjmë me një prirje inçest të vëllait ndaj motrës.

– Pa shih, pa shih - ia bëri Stresi.” (Kadare 2004:).

Një inçest i pakryer. Për këtë arsye Konstandini e martoi larg të motrën:

“Me martesën larg Konstandini mendoi se shpëtoi prej inçestit. Por si do të shohim jo largësia por edhe vdekja s’të shpëton dot prej tij- vazhdoi ndihmësi” (Kadare 2004:).

Ky mendim i ndihmësit e çmendi më shumë Stresin. Tashmë dukej sikur kjo çështje nga detyrë i ishte kthyer në personale. Duhej gjetur një zgjidhje më se s’bën.

Që në orët e para të mëngjesit Stresit i vjen lajmi i shumëpritur:

“ – Stres, u kap sjellësi i Doruntinës, - tha ndihmësi.

Stresi mbeti një grimë me gojë hapur. – Si është e mundur?” (Kadare 2004:)

Ky ishte një lajm i papritur. Ndoshta do i jepte zgjidhje misterit dhe të gjithë nuk do të flisnin për ringjalljen e Konstandinit. Thonin që i arrestuari kishte folur në gjumë e kishte thënë fjalë, të cilat të çonin të mendoje që kishte të bënë me ardhjen e Doruntinës. Por kur Stresi e merr në pyetje ai mohon gjithçka dhe thotë se nuk e njeh kush është Doruntina. Stesi urdhëron që ta vënë në torturë: *“Sapo pa veglat e torturës pohoi menjëherë”* (Kadare 2004:). Që të pranonte kaq shpejt Stresi nuk e priste.

Stresi merr të burgosurin në pyetje. Sapo hyri Stresi i burgosuri tha: *“në të vërtetë do të kasha bërë mirë ta kisha pohuar qysh në fillim - tha ai, pa prituri që Stresi t’i drejtonte ndonjë pyetje /.../ unë jam shitës ambulant ikonash /.../ Një ditë u njoha me Doruntinën dhe ajo më pyeti se ç’bëhej në Arbëri /.../ E binda të vinte mua dhe të shkruante një letër se u largua me të vëllanë Konstandinin”* (Kadare 2004:). E gjithë historia e të burgosurit kur e dëgjoje dukej e vërtetë. Por për habinë e të gjithëve Stresi e vendosi përsëri në torturë:

“- Vëreni në torturë, - urdhëroi.

– Në torturë? - pyeti ndihmësi me zë të ulët.” (Kadare 2004:). Të gjithë ky vendim i habitit. Mos vallë Stresi nuk e besoi? Apo ishte xheloz? Nuk dinin si të shpjegonin sjelljen e tij. Stresi shkruan raportin ku flet për kapjen e sjellësit të Doruntinës dhe çfarë kishte deklaruar.

Nga momenti në moment pritej të bëhej për të treguar se ç’kishte ndodhur atë natë kur erdhi Doruntina. Të gjithë ishin sy e vesh të atyre se

ç’do të ndodhnin, sepse kjo histori ishte bërë aq e madhe sa ishte dëgjuar deri në Konstandinopojë. Thashetheme të shumta ishin hapur. Dikush thoshte se i burgosuri ishte i dërguari i kishës së Romës. Disa thoshin se Doruntina ishte viktimë e kishës. Stresi qeshte gjithmonë në mënyrë enigmatike kur i dëgjonte këto histori. Veçse ku takoi katër shokët e Konstandinit.

Ismail Kadare e paraqet Kostandinin sikur donte që ta përdorte *besën* si institucion dokësor, si boshtin e ndërtimit të një modeli të ri politik dhe social për shoqërinë dhe popullin arbër, të ndryshëm nga modelet që ofronte Lindja dhe Perëndimi, të cilat Kostandini i gjenë si të papranueshme dhe të rrezikshme. Konstandini arriti të mbante besën.

Mbledhja e shumëpritur po zhvillohej më në fund. Ajo u zhvillua në Manastirin e Tri Kryqeve. Në fillim filloi fjalimin e tij **kryeshkopi**, i cili tregonte për mashtrimin e madh të Doruntinës. Atë nuk e solli Konstandini, por dashnori i saj. Pas tij filloi të flasë Stresi dhe e tregoi të gjithë historinë me detaje. Tashmë edhe pse e dinin të gjithë se cilin qëndrim mbante, në mendjen e Stresit bluante **pyetja e papërgjigje**: kush e solli Doruntinën në të vërtetë?:

- E solli fjala e dhënë, besa shqiptare?

- Pengu i një inçesti të pakryer?

- Një aventurier?

Ai deklaroi se ka rënë pre e një mashtruesi i cili ka krijuar një histori që nuk ekzistonte. Për këtë arsye ai e vendosë në torturë për të dytën herë. Po ai tashmë e dinte kush e solli Doruntinën dhe askush nuk ia ndryshonte atë bindje, madje as **kryeshkopi**:

“Ju të gjithë keni dëgjuar besoj për dasmën e çuditshme të Doruntinë Vranajt, që u bë shkak për këtë histori. Ju keni dëgjuar besoj për një krushqi e largët /.../ nuk do të bëhej, në qoftë se Konstandini, njëri prej vlezërve të nuses nuk do t’i jepte besën nënës se do t’ia sillte Doruntinën sa herë të lipsej, në gaz apo në zi. Ju e dini sa shpejt erdhi zia për Vranajt, por Doruntinën nuk e solli askush, sepse dhënësi i besës, Konstandini kishte vdekur. Ju keni dëgjuar dhe për mallkimin që i bëri nëna të birit në varr. Dhe e dini se tri javë pas mallkimit Doruntina erdhi në shtëpi. Ja përse unë

e shpall dhe e rishpall se Doruntinën nuk e solli askush tjetër, veçse i vëllai i saj, Konstandini, fjala e dhënë e tij, besa e tij. S'ka rëndësi u ngrit apo s'u ngrit i vdekuri nga varri /.../ Secili nga ne ka marrë pjesë në këtë udhëtim, sepse besa e Konstandinit, ajo që solli Doruntinën, ka mbirë këtu midis nesh. Pra për të qënë më i saktë, duke e sjellë Konstandini, e sollëm të gjithë ne, unë, ju, të vdekurit që pushojnë atje te kasha.” (Kadare 2004:).

Rëndësi tashmë ka që Doruntina u kthye në shtëpi, domethënë u vu fjala në vend, u mbajt premtimi. Kush ishte ai që e mbajti besën, ai që e shpuri fjalën e dhënë në vend, ai se me cilin u kthye Doruntina, mbetet çështje e dorës së dytë.

Përfundime

Aftësia e Kadaresë për t'u dhënë krijimeve të tij letrare një karakter unikal dhe universal është një ndër vlerat më të veçanta dhe më të shquara, e origjinale të artit Kadarean. Kjo është edhe arsyeja më e madhe që të drejtohem drejt krijimtarisë së tij. Kadareja është ndër të vetmit autor shqiptar që është vlerësuar nga kritikë të njohur botërorë dhe është vlerësuar se veprat e tij karakterizohen nga tematika që trajtojnë probleme të rëndësishme të të gjithë shoqërisë shqiptare. Ai zbulon historinë, virtytet e shpirtit të popullit. Këto i bën për arsye që të qëndrojnë sa më afër lexuesit, të tregojë atë çka atyre u nevojitet dhe të shprehë atë çka njerëzit e thjeshtë nuk e kanë mundësinë.

Një ndër romanet më të njohur të tij është edhe *Kush e solli Doruntinën*, i cili, në thelb dhe nën hijen e të gjithë asaj legjende rri fshehur brenda e një populli të shtypur dhe të mbyllur, e që sa vjen i harron vlerat dhe traditat e tij. Thelbi i kësaj vepre është fjala e dhënë, besa shqiptare,

dhe Kadare ka dashur jo vetëm ta himnizojë besën shqiptare, por edhe t'i jepte asaj një përmasë më të madhe.

Kadare me mjeshtërinë e tij arrin që ta mbaje të gozhduar lexuesin me të papriturat që sjell në çdo kapitull, apo fragment. Tashmë problemi i veprës nuk ishte se si erdhi Doruntina, por kush e solli atë. Hipotezat e ndryshme bëjnë që kapiteni Stres të krijojë forma historishë të mundshme se si mund të ketë ardhur Doruntina. Porsa duket sikur e gjithë enigma është zgjidhur dhe i ka ardhur fundi, një e papritur tjetër ndryshon rrjedhën e ngjarjes. Këtë gjë Kadare e bën për të mbajtur gjallë kureshtjen e lexuesit.

Kadare i paraqet shqiptarët sikur tradicionalisht kanë qenë një popull idhujtarë, pra barbarë, që historikisht kanë qenë refuzues të qytetërimit, si atij lindor, ashtu dhe atij perëndimor, gjë që vazhdojnë ta bëjnë ende. Kostandini është një njeri që kërkonte të përpunonte një model shqiptar politik, social, kulturor, krejt ekskluziv. Këtë ai kërkonte ta tregonte me virtytin më të rëndësishëm të shqiptarit që pavarishtë çdo gjëje, ai ka mbizotëruar të gjithave kohërave. Ky virtyt është Besa.

Bibliografia

- Sh. Sinani, “Një dosje për Kadarenë”, Tiranë
 A. Aliu, “Miti ballkanik te Kadareja”, Tiranë, 2006
 T. Çausi, “Universi letrar i Kadaresë”, Tiranë, 1993
 I. Kadare, “Vepra letrare”, vëll. 8
 Sh. Sinani, “Pengu i moskuptimit”, Tiranë, 1997
 Sh. Sinani, “Për prozën e Kadaresë”, Tiranë, 2009
 I. Kadare, “Kush e solli Doruntinën”, Tiranë, 2004.

